

IF

3.
AUTOSTRADA
BIENNALE

A

01.07-11.09
2021

EY





3. AUTOSTRADA BIENNALE



KURUAR NGA/
CURATED BY
ÖVÜL Ö. DURMUŞOĞLU &
JOANNA WARSZA

PRISHTINA 01.07-
PRIZREN 17.07-
PEJA 19.07-
11.09.2021

PRISHTINA: AGNES DENES,
PETRIT HALILAJ & ALVARO URBANO

PRIZREN: AGNES DENES, ALBAN MUJA,
AGNIESZKA POLSKA, AGRON BLAKÇORI,
BANU CENNETOĞLU, BORA BABOÇI,
CAMILA ROCHA, COOKING SECTIONS &
FEJSAL DEMIRAJ, DORUNTINA KASTRATI,
EDONA KRYEZIU, FERNANDO GARCÍA-DORY,
FLAKA HALITI, GÜLSÜN KARAMUSTAFA,
HAVEIT, HERA BÜYÜKTAŞCIYAN, IMAN ISSA,
IRAMAMAMA, MAŁGORZATA MIRGA-TAS & EDIS
GALUSHI, MARWA ARSANIOS, NÚRIA GÜELL
& LUMNIJE GËRGURI STOJKAJ, ROSSELLA
BISCOTTI, SEZGİN BOYNIK & TEVFİK RADA,
ULF AMINDE & MANUEL GOGOS, VAHIDA
RAMUJKIĆ, VALBONA ZHERKA

PEJA: EX-EXIT WITH AGUSH BEQIRI,
HÜSEYİN BAHİRİ ALPTEKİN

ÇKA NËSE NJË RRUGËTIM...

ËSHTË NJË EKSPOZITË PËR TË
PAPËRFUNDUARËN. MUND TË JETË NJË
RRUGË, NJË HARTË ELEKTRIFIKIMI,
NJË SHTËPI, NJË FUSHË ME LULE,
NJË TREGIM, NJË MARRËDHËNIE OSE
NJË SHTET. ËSHTË EKSPOZITË QË
PAPLOTËSINË E MERR SI FTESË PËR
T'U PËRGJIGJUR, PËR T'U LIDHUR
DHE PËR T'U RRITUR.

WHAT IF A JOURNEY...

IS AN EXHIBITION ABOUT
THE UNFINISHED. IT CAN BE
A ROAD, AN ELECTRIFICATION MAP,
A HOUSE, A FLOWER FIELD,
A STORY, A RELATIONSHIP,
OR A COUNTRY. IT IS AN EXHIBITION
THAT TAKES INCOMPLETENESS AS
AN INVITATION TO RESPOND,
TO RELATE, AND TO GROW.

ÇKA NËSE NJË RRUGËTIM...

ËSHTË EKSPOZITË PËR DY SKAJET
E RRUGËS QË TAKOHEN NDËRMJET
MIKPRITËSIT E TË FTUARIT,
NDËRMJET TË MËRGUARËS E VENDORES,
NDËRMJET INFRASTRUKTURËS DHE
INTIMITETIT.

WHAT IF A JOURNEY...

IS AN EXHIBITION ABOUT TWO ENDS
OF THE ROAD THAT MEET IN BETWEEN
A HOST AND A GUEST, IN BETWEEN THE
DIASPORIC AND THE LOCAL, IN BETWEEN
INFRASTRUCTURE AND INTIMACY.

ÇKA NËSE NJË RRUGËTIM...

ËSHTË POASHTU EKSPOZITË PËR ARTIN
SI FORMË E RIKUPERIMIT NGA KURTHET
E PËRDITSHMËRISË. TË MERR ME VETE E
TË SHPIE NË NJË RRUGËTIM, DUKE
FILLUAR NGA QENDRA E PRISHTINËS,
E PËRGJATË RRJEDHËS SË LUMBARDHIT
NË PRIZREN, PËR TË PËRFUNDUAR NË
NJË BAR ARTI NË PEJË.

WHAT IF A JOURNEY...

IS ALSO AN EXHIBITION ABOUT ART AS
A FORM OF RECOVERY FROM EVERYDAY
TRAPS. IT TAKES YOU ON A ROAD TRIP
STARTING IN THE CENTER OF PRISHTINA,
CONTINUING ALONG THE LUMBARDHI RIVER
IN PRIZREN, AND ENDING IN AN
ART BAR IN PEJA.

PUNA NË BIENALE GJATË PANDEMISË NA
KA BËRË TË KUPTOJMË SE ARTI SOT
ËSHTË MBI TË GJITHA NJË FORMË E
RIMËKËMBJES, NJË URË E GJITHANSHME
NDËRMJET NEVOJAVE TË ASAJ QË MBETET
BRENDA DHE ASAJ QË NDODHET JASHTË.

PËRKUNDËR KUFIJVE TË MBYLLUR,
BRENGAVE TË SHËNDETIT PUBLIK,
TESTIMEVE TË RREGULLTA DHE MBYLLJEVE
TË HERËPASHERSHME, EKSPOZITA, QË
ZHVILLOHET KRYESISHT NË HAPËSIRËN
PUBLIKE, ËSHTË GJITHASHTU NJË TEST
I REZISTENCËS DHE QËNDRUESHMËRISË.

“PËRDERISA RRUGËTOJMË, SHPRESOJMË”,
THOTË VALBONA ZHERKA, NJË ARTISTE,
PUNA E SË CILËS KA QENË SHUMË SHPESH
E MARGJINALIZUAR NË TË KALUARËN.
GRUMBULLI I SAJ I ENDUR I RRUGËVE
TË MBIVENDOSURA NA OFROI NJË
HARTË ORIENTIMI TË PËRBËRË NGA
RRJEDHAT E LUMENJVE, RRUGËT E
ARRATISJES, SHTIGJET E MIGRIMIT,
PARREGULLSITË POZITIVE, KTHESAT
NË FORMË U, MËNYRAT E PAPRITURA
TË NISJES DHE ARRITJES.

EDICIONI I 3-TË I AUTOSTRADA
BIENNALE ËSHTË FTESË PËR NJË
UDHËTIM TË PAPËRFUNDUAR, KU ARTI
DHE MBIJETESA FORMOJNË ÇANTËN E
EMERGJENCËS NË RRUGËTIMIN DREJT SË
TASHMES, BRENDË DHE JASHTË KOSOVËS
PËR NË BERLIN, STAMBOLL, VARSHAVË
DHE PRAPA. OSE DIKU NDËRMJET.

WORKING ON THE BIENNALE DURING
THE PANDEMIC HAS MADE US REALIZE
THAT ART TODAY IS FOREMOST A FORM
OF RECOVERY, A VERSATILE BRIDGE
BETWEEN THE NEEDS OF WHAT REMAINS
INSIDE AND WHAT IS SITUATED OUTSIDE.
DESPITE CLOSED BORDERS, PUBLIC
HEALTH CONCERNS, REGULAR TESTS,
AND OCCASIONAL LOCKDOWNS, THE
EXHIBITION, TAKING PLACE PRIMARILY
IN PUBLIC SPACE, IS ALSO A TEST OF
RESISTANCE AND RESILIENCE.

“AS LONG AS THERE IS A JOURNEY,
THERE IS HOPE,” SAYS VALBONA ZHERKA,
AN ARTIST WHOSE WORK HAS TOO OFTEN
BEEN MARGINALIZED IN THE PAST.

HER WOVEN CLUSTER OF OVERLAPPING
ROADS OFFERED US AN ORIENTATION MAP
COMPOSED FROM RIVER FLOWS, ESCAPE
ROUTES, MIGRATION PATHS, POSITIVE
IRREGULARITIES, U-TURNS, UNEXPECTED
MODES OF DEPARTURE AND ARRIVAL.

THE THIRD AUTOSTRADA BIENNALE IS AN
INVITATION TO AN INCOMPLETE JOURNEY,
WHERE ART AND SURVIVAL FORM THE
EMERGENCY KIT ON A ROAD TRIP TO THE
PRESENT, IN AND OUT OF KOSOVO—TO
BERLIN, ISTANBUL, WARSAW, AND BACK.
OR SOMEWHERE IN BETWEEN.

PARATHËNIE



FOREWORD

Autostrada Biennale filloi në Prizren, Kosovë, në vitin 2014, me edicionin e parë në vitin 2017. U ndërtua mbi nevojën për më shumë shkëmbime kulturore në rajon dhe me botën.

Ne gjithmonë e kemi imagjinuar atë si një pikë ndërlidhëse, një rrugë në hartën e Ballkanit Perëndimor. Pandemia na ka bërë që ta rimendojmë modelin e bienales dhe si rezultat, me entuziazëm i kemi shtrirë aktivitetet tona edhe në dy qytete. Në këtë mënyrë, ne vazhdojmë punën në idetë tona themeltare: lokal por shumë të ndërlidhur.

Qëllimi ynë kryesor është ta sjellim artin në jetën e njerëzve, në zakone, modele të të jetuarit dhe punuarit; për të krijuar mjedise të imagjinatës dhe përjetimit. Kjo është arsyeja pse ne angazhohemi në hapësira publike. Duke përdorur hapësira që na përkasin të gjithë neve—stacioni i autobusëve, shtrati i lumit, shtëpitë e kopshtet tradicionale—ne duam të nxisim momente të shkëmbimeve artistike dhe të përditshme, ndërmjet artit dhe njerëzve duke u ofruar një platformë për reflektim, mendim kritik dhe përvojë estetike.

Si institucioni i vetëm i artit bashkëkohor në Prizren, Autostrada Biennale funksionon me dy shpejtësi: njëra është ekspozitë fizike që zhvillohet çdo dy vjet, tjetra është hapësira

Autostrada Biennale started in Prizren, Kosovo, in 2014, with its first edition opening in 2017. It was built on the need for more cultural exchange in the region and with the world.

We always imagined it as a connecting point, a route on the map of the Western Balkans. The pandemic demanded that we rethink the biennale model, and, as a result, we have enthusiastically extended our activities into two other cities. In this way, we continue the work of our founding ideas: local yet very connected.

Our main goal is to bring art into the lives of people, into habits, living and working patterns; to create environments of imagination and evocation. This is why we engage in public space. By using spaces that belong to all of us—the bus terminal, the river bed, and traditional houses and gardens—we want to foster moments of artistic and everyday exchange, between art and people, gently providing the curious with platforms for reflection, critical thinking, and aesthetic experience.

As the only contemporary art institution in Prizren, Autostrada Biennale functions on two speeds: one is a physical exhibition that

jonë e re e edukimit dhe prodhimit në ish bazën ushtarake të KFOR-it. Me këtë të fundit, në shpresojmë të zgjerojmë hapjen ndaj publikut duke konsideruar prodhimin e artit si një formë të të mësuarit.

Përmes edukimit, trajnimit dhe prodhimit të hapur drejt ekspozimit, qëllimi ynë është të zhvillojmë modele të reja të krijimit kulturor që do të inkurajojnë brezin e ri të mendoj në mënyrë kritike për artin dhe të bëhet pjesë e procesit të ndërtimit dhe instalimit të veprave artistike.

Programet publike të Autostrada Biennale përpiqen të ndihmojnë hapësirat e të mësuarit për brezat e rinj duke ndjekur parimin e gjithëpërfshirjes, duke e bërë programin të hapur për komunitete të ndryshme.

Së bashku me artistët tonë të ftuar ne nxisim debat kritik rreth shqetësimeve artistike, sociale dhe politike në shoqërinë tonë.

Jemi më se të lumtur që jemi në këtë udhëtim së bashku me kuratorët tona Övül. Durmuşoğlu dhe Joanna Warsza, të cilat janë angazhuar në biseda të gjata me artistë vendor dhe ndërkombëtarë. Puna në biennale gjatë pandemisë nuk ishte e lehtë, por megjithatë arti e ka dëshmuar veten si formë e

takes place every two years, the other is our new education and production space in the former KFOR military base. With the latter, we hope to extend the publicness of our platform by considering art production as a form of learning.

Through education, onsite training, and an open exhibition-making production space, our aim is to develop new models of cultural creation that will encourage a young generation to think critically about art and to become part of the process of building and installing art.

The Autostrada Biennale's public programs strive to facilitate learning spaces for younger generations by following the principle of inclusivity, making the program open to different communities.

Together with our invited artists we encourage critical debate around artistic, social, and political concerns in our society.

We could not be more happy to be on this journey together with our curators Övül Ö. Durmuşoğlu and Joanna Warsza, who have engaged in extended conversations with local and international artists. Working on this biennale during the pandemic was not

qëndrueshmërisë dhe rimëkëmbjes.

Poashtu, dëshirojmë t'i falënderojmë të gjithë partnerët, kolegët dhe miqtë, pa të cilët kjo ekspozitë, në tre qytete, nuk do të ishte e mundur.

Ju mirëpresim përzemërsisht në edicionin e tretë të Autostrada Biennale, me temat e paplotësisë dhe një rrugëtim. Jemi të bindur që do të jetë një rrugëtim provokues dhe emocionues që do t'ju hap oreksin për më shumë.

Leutrim Fishekqiu
Vatra Abrashi
Bariş Karamuço

Bashkëthemelues dhe drejtorë të
Autostrada Biennale

easy, and yet art has revealed itself as a form of resilience and recovery. We are proud to present this multilayered edition.

We also would like to also extend our thanks to all partners, colleagues, and friends without whom this exhibition, in three cities, would not be possible.

We warmly welcome you to the third edition of the Autostrada Biennale, with its themes of incompleteness and a journey. We are sure it will be a thought provoking and exciting trip that will leave you with an appetite for more.

Leutrim Fishekqiu
Vatra Abrashi
Bariş Karamuço

Cofounders and directors of
Autostrada Biennale

3.AUTOSTRADA BIENNALE

WHAT IF A JOURNEY...

PRISHTINA

01.07–
11.09.2021

“Të gjithë ne mund të jemi si lulet”, na thotë Agnes Denes. “Ne mund të rritemi, të ushqehemi, t’u dhurojmë të tjerëve pasurinë tonë, të kthehemi kah dielli dhe pastaj të pasqyrojmë ngrohtësinë e tij tek të gjitha krijesat e gjalla.” Kapitulli i parë i Autostrada Biennale në Prishtinë është krijuar rreth infrastrukturës së thjeshtë: një fushë lulediejsh e sapombjellur në qendër të qytetit nga artisja ikonike feministe Agnes Denes si dhe një instalacion madhështor i luleve nga tekstili, *Lule Mosmëharro*, nga Petrit Halilaj dhe Alvaro Urbano, nën kupolën e Bibliotekës Kombëtare. Të dy projektet janë mishëruar nga toka dhe lulja, që kanalizojnë domosdoshmërinë për transformim shoqëror. Ato lidhen me tokën, ujin, dritën —të gjitha këto që nuk mund të merren si të mirëqena. Ato bashkojnë perspektivat mikro dhe makro, kujtimet personale të çlirimit dhe transformimit ndërsa kremtohet jokonformiteti. Lulet poashtu u përgjigjen me dhembshuri shtresave të traumës dhe dhunës, me një thirrje për diversitet; për histori, specie dhe komunitete të ndryshme.

Në bisedë të afërt, si *Fushat e Lulediellit* ashtu edhe *Lule Mosmëharro*, krijojnë shtigje për të formësuar mënyrat e ardhshme të

“We all can be like flowers,” Agnes Denes tells us. “We can grow, nourish, endow others with our richness, turn to the sun, then reflect its warmth to all living creatures.” The first chapter of the Autostrada Biennale in Prishtina is built around quotidian infrastructures: a newly planted sunflower field in the city center by iconic feminist artist Agnes Denes, and a majestic textile flower installation, *Forget Me Not*, by Petrit Halilaj and Alvaro Urbano under the cupola of the National Library. Both projects are embodied by the earthly and floral, which channel the need for societal transformation. They connect to soil, water, light—all of which cannot be taken for granted. They merge micro and macro perspectives, personal memories with the need for liberation and transformation; they celebrate nonconformity. The flowers also respond compassionately to layers of trauma and violence with a call for diversity; for different histories, species, and communities.

In close conversation, both *Sunflower Fields* and *Forget Me Not* make pathways to shape future social, artistic, and political modes of survival within the current structures and infrastructures of the city and beyond.

mbijetesës shoqërore, artistike dhe politike, brenda strukturave dhe infrastrukturës aktuale të qytetit dhe më tej. Një nga pyetjet kuratoriale të edicionit të tretë të Autostrada Biennale është se si mundet arti t'u japë dëshirave një formë poetike por konkrete, dhe se si ai ndërmjetëson nevojat për hapësirat e domosdoshme të frymëmarrjes.

One of the curatorial questions of the third Autostrada Biennale is how art can give desires a poetic yet concrete form, and how it mediates needs for essential breathing spaces.



(PY)
Pallati i Rinisë dhe Sporteve/
Palace of Youth and Sports
Agnes Denes

(NL)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës/
The National Library of Kosovo
Petrit Halilaj & Alvaro Urbano



(P Y)

PALLATI I RINISË
DHE SPORTEVE/
PALACE OF YOUTH
AND SPORTS

RRUGA LUAN HARADINAJ

AGNES DENES

Pallati i Rinisë dhe Sporteve është një sallë e vendosur në qendër të Prishtinës. Përfshin një qendër tregtare, parkim të brendshëm, dy salla kongresesh dhe një bibliotekë. Në vitin 1975 është mbajtur një referendum ku qytetarët e Prishtinës kanë votuar për ndërtimin e një salle shumëfunktionale. U përfundua në 1977 dhe fillimisht u emërua Boro dhe Ramiz, pas dy partizanëve jugosllavë të Luftës së Dytë Botërore me origjinë serbe dhe shqiptare. Ndërtesa mbart shumë trauma në vete dhe u dëmtua rëndë nga një zjarr në vitin 2000. Tani është restauruar pjesërisht, por shumë nga dëmet janë ende të dukshme. Struktura e ndërtesës origjinale asimetrike pasqyron pozicionin midis utopisë së dështuar, harresës dhe një fillimi të ri të materializuar në monumentin Newborn të ngritur pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Është një vend urbanistik në të cilin historitë e së kaluarës dhe të tashmes së trazuar jetojnë në arkitekturën e saj.

The Palace of Youth and Sports is a hall located in the center of Prishtina. It includes a shopping mall, indoor parking, two convention halls, and a library. A referendum was held in 1975 where citizens of Prishtina voted in favor of building a multifunctional hall. It was finished in 1977 and was originally named Boro and Ramiz, after two World War II Yugoslav partisans of Serbian and Albanian origin. The building carries a lot of trauma and was heavily damaged in a fire in 2000. Now it is partly restored, but much of the damage is still visible. Its original asymmetric structure reflects its position between failed utopia, oblivion, and a new beginning materialized in the Newborn monument erected after the declaration of the independence of Kosovo in 2008. It is an urban site in which stories of Kosovo's turbulent past and present live in its architecture.



AGNES DENES

SUNFLOWER FIELDS/
FUSHAT E LULEDIELLIT

2021

IN COLLABORATION WITH
MANIFESTA 14 PRISHTINA

“Për lulediellin u interesova së pari derisa mbillja arën time me grurë. Duke realizuar hulumtimin tim të zakonshëm në vazhdimësi, mësova se përzierja e grurit me lulediellin ndihmon për të mbajtur dheun të pasur. Më vonë kur më ftuan të shkruaj një ese në një libër për tokën, unë e përdora këtë njohuri për të prezantuar mënyra të ndryshme se si duhet ta mbajmë pjellor këtë burim të çmuar; duke alternuar mbjelljen e grurit gjatë një sezone dhe lulediellit në sezonën tjetër do të sigurohet pjelloria e tokës. Ne e pranojmë dheun dhe nuk mendojmë shumë për ekzistencën e tij, e megjithatë e gjithë jeta varet nga kjo shtresë e hollë që e rrethon globin. Luledielli është bimë e lumtur dhe nënkupton shumë gjëra në kultura të ndryshme. Për kinezët ajo sjell fat të mirë ndërsa për fisin Incas ajo simbolizon Zotin e Diellit. Jam e lumtur që po i mbjellni këto lule, në të gjitha fushat e mundshme. Do të sjellin kënaqësi dhe mirëqenie, sikurse të gjitha gjërat që rriten dhe janë të gjalla. Kur gjërat rriten, lulëzojnë, jeta shprehë transformimet dhe sekretet e saja. Shikoni, dëgjoni dhe merrni pjesë! Ne të gjithë mund të bëhemi si luledielli—të rritemi, të ushqehemi, t’u dhurojmë të tjerëve pasurinë tonë, të kthehemi drejt Diellit, e të reflektojmë ngrohtësinë e tij te të gjitha krijesat e gjalla.”

Agnes Denes, një artiste ikonike feministe me origjinë hungareze, e cila jeton e vepron në New York, deklaroi në *Manifeston* e saj të vitit 1969, se donte ta braktiste kullën e fildishtë të studios së saj dhe të hynte në botën e shqetësimeve të vërteta globale, “duke komunikuar të pakomunikueshmen,” “duke

Agnes Denes (1931) ka lindur në Budapest dhe jeton në New York City.

“I originally became interested in sunflowers while planting my wheat field. In doing my usual constant research I learned that alternating planting wheat and sunflowers helps to keep the soil rich. Later when I was invited to write an essay for a book about soil, I used this knowledge to impart the many ways we must keep this precious resource fertile; alternating planting wheat one season and sunflowers the next will ensure the soil’s fertility. We accept soil and think little of its existence, but all life depends on this thin layer surrounding the globe. Sunflowers are happy plants that mean many things in different cultures. For the Chinese they are good luck and for the Incas they symbolized the Sun God. I am glad you are planting these flowers, in all possible areas. It’ll bring pleasure and well-being, as do all things that grow and live. When things grow, blossom, life is expressing its transformations and secrets. Watch, listen, participate. We all can be like sunflowers—grow, nourish, endow others with our richness, turn to the sun, then reflect its warmth to all living creatures.”

Agnes Denes, an iconic, feminist, New York-based artist of Hungarian origin, declared in her 1969 *Manifesto* that she wanted to leave the ivory tower of her studio and enter the world of the global concerns, “communicating the incommunicable,” “visualizing the invisible,” “not accepting the limitations society has accepted,” and “persisting in eternal search.” Throughout her life and career she has imagined and initiated visionary experiments of cohabitation through art. Her well-known statement work *Wheatfield–The Confrontation* (1982), two

Agnes Denes (1931) was born in Budapest and lives in New York City.

vizualizuar të padukshmen,” “duke mos i pranuar kufizimet që shoqëria i ka pranuar,” dhe “duke këmbëngulur në kërkimin e përjetshëm.” Gjatë jetës dhe karrierës së saj, Denes ka imagjinuar dhe iniciuar eksperimente vizionare të bashkëjetesës përmes artit. Vepra e saj e njohur emblematike *Fushë gruri-Ballafaqimi* (1982), dy hektarë grurë të mbjellur në një deponi rrënojash të shpërndara në Manhattan pranë Wall Street, interpretoi trashëgiminë e artit të



tokës dhe e shndërroi atë në një ndërhyrje ekologjike urbane, duke sugjeruar se ku do të zhvilloheshin betejat e ardhshme. Denes, ende duke prodhuar aktivisht edhe në të nëntëdhjetat, për

Autostrada Biennale ka propozuar një punë të re të dy fushave me luledielli, të cilat do të mbjellen në qendër të qytetit në Prishtinë dhe Prizren. Si gjini, *Helianthus*, luledielli vjen nga fjalët greke helios (dielli) dhe anthos (një lule). Fillimisht ishte kultivuar nga kulturat indigjene, e pastaj, përmes Rusisë, bëri rrugë për në Evropë dhe më pas erdhi në Ballkan, duke u bërë bimë simbolike për Kosovën në kohën e Jugosllavisë, e cila nga atëherë pothuajse është zhdukur në tërësi. Një ndërhyrje ndjekë diellin, lulediejt rishfaqen në mes të qyteteve që përballen me ndotjen dhe gjentrifikimin, si—me fjalët e artistes—një gjest për të “parë realitetin dhe megjithatë për të qenë në gjendje për të ëndërruar”.



acres of wheat planted on a rubble-strewn landfill in Manhattan near Wall Street, interpreted the heritage of environmental art and turned it into an urban ecological intervention,

suggesting where future struggles would take place. For Autostrada Biennale, Denes, still actively producing in her nineties, proposed a new work of two sunflower fields to be planted in the centers of Prishtina and Prizren. The sunflower’s genus, *Helianthus*, comes from the Greek words *helios* (sun) and *anthos* (flower). It was first cultivated by indigenous cultures, and then, through Russia, made its way to Europe and subsequently to the Balkans, becoming a symbolic plant for Kosovo in the Yugoslav era, and which has since almost vanished. An intervention that follows the sun, sunflowers reappear in the middle of cities struggling with pollution and gentrification, as—in words of the artist—a gesture of “seeing reality and still being able to dream.”



(N L)

BIBLIOTEKA
KOMBËTARE E
KOSOVËS/
THE NATIONAL
LIBRARY OF KOSOVO

SHESHI HASAN PRISHTINA

PETRIT HALILAJ &
ALVARO URBANO

Misioni i Bibliotekës Kombëtare të Kosovës është mbledhja, ruajtja, promovimi dhe vënia në dispozicion e dokumenteve të shkruara dhe trashëgimisë intelektuale të Kosovës. Ajo është vendosur në një ndërtesë të jashtëzakonshme prej shumë kupolave, e projektuar nga arkitekti kroat Andrija Mutnjaković, e cila u inagurua në vitin 1982. Ndërtesa është inspiruar nga tiparet arkitektonike të gjetura në ndërtesat fetare të rajonit, kubi dhe kupola, dy forma të trashëguara nga tradita bizantine dhe osmane të pranishme në Kosovë. Është ndërtuar nga struktura e betonit, veshur me mermer dhe llaç të bardhë, ndërsa fasadat dhe kupollat janë të mbuluara me mbështjellës në formë rrjete nga alumini. Rrjetat metalike të përdorura si mbrojtëse kundër rrezeve të diellit krijojnë një mjedis të këndshëm për lexuesit, me një referencë për traditën e filigranit. Nga një pamje ajrore, biblioteka duket si një grumbull kubesh, me madhësi dhe lartësi të ndryshme, duke dhënë një ndjenjë mbrojtjeje, e cila përforcohet më tej nga rrjeti prej alumini i gjashtëkëndëshave të mbështjellë mbi ndërtesë. Gjatë luftës në Kosovë (1998-99) ndërtesa është përdorur për të akomoduar refugjatë kroatë dhe boshnjakë. Ushtria serbe e përdori atë gjithashtu si një qendër komanduese, gjatë së cilës shumë libra historik u shkatërruan. Sot është ende një nga ndërtesat më ikonike në rajon, duke koordinuar të gjitha bibliotekat në të gjithë Kosovën.

The mission of the National Library of Kosovo is to collect, preserve, promote, and make accessible written documents and the intellectual heritage of Kosovo. It is housed in an extraordinary building of many domes, designed by Croatian architect Andrija Mutnjaković and inaugurated in 1982. The building was inspired by two architectural features found in the region's religious buildings, the cube and the dome, relics from Byzantine and Ottoman tradition still present in Kosovo. It was constructed using concrete, marble, and white plaster, while the facades and the domes are covered with aluminum lattice wrapping. Metal grids used as sunlight protectors create a pleasant environment for readers, with a nod to the filigree tradition. From an aerial view, the library appears as a cluster of cubes of varying sizes and heights, giving a sense of protection, which is further reinforced by the aluminum net of hexagons draped over the building. During the Kosovo War (1998–99) the building was used to accommodate Croatian and Bosnian refugees. The Serbian army also used it as a command center, during which many historical books were destroyed. Today it is still one of the most iconic buildings in the region, coordinating all libraries across Kosovo.



PETRIT HALILAJ &
ALVARO URBANO

FORGET ME NOT/
LULE MOSMËHARRO

2020-21

IN COLLABORATION WITH
THE 5TH ANNUAL KOSOVO PRIDE WEEK,
MANIFESTA 14 PRISHTINA,
AND THE NATIONAL LIBRARY

Lule Mosmëharro është një instalacion lulesh madhështore të krijuara nga pëlhura nën kupolat e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, ndërtesë kjo arkivore e kujtesës dhe dijes kolektive. Secila lule veçmas në këtë konstelacion—qoftë boshtra, farat e palmës, luleqershija, luleftoi, ose karanfili—ngërthejnë në vetvete një domethënie si për historitë personale, gjithashtu edhe për lidhjen e të dy artistëve me njëri tjetrin. Këto lule gjithashtu shërbejnë si përkufizues të potencialit që kujtesa personale mbartë më vete për ta rishkruar gradualisht kujtesën kolektive. Lulet e prezantuara mishërojnë format e dashurisë, dëshirat seksuale, intimitetin, lidhjet, dhe identitetin, në përgjithësi, e sidomos të atyreve që janë vazhdimisht të lënë, e të lëna anash, apo të shtypur, e të shtypura nga politikat dhe normat regresive të krijuara nga shoqëria.

Lulet ishin ekspozuar në Madrid, Spanjë, shtet i cili nuk e njeh pavarësinë e Kosovës dhe si rrjedhojë ua pamundëson kosovarëve hyrjen në këtë shtet. Në Prishtinë, lulet vijnë me një bashkëpunim të vecantë për rastin e edicionit të 5-të të Javës së Krenarisë në Kosovë. *Lule Mosmëharro* poashtu e mbështetë kampanjën qytetare për të drejta të barabarta në Kosovë, veçanërisht për komunitetin LGBTQI+, fushatë kjo që kërkon nga hartuesit e Kodit të ri Civil të përfshijnë aty të drejtën e martesës. Vepra e fuqizon kampanjën me bukurinë e luleve—tani edhe si imazh i saj zyrtar. Kushtetuta e Kosovës, e krijuar në vitin 2008, e frymëzuar nga vlerat progresive dhe barazitare hap rrugë për martesën dhe mundësinë e adoptimit nga personat e komunitetit LGBTQI+, por kodi civil akoma nuk përputhet me vlerat kushtetuese.

Instalacioni shoqërohet nga zine *Kushtetuta*, iniciuar nga Halilaj dhe Urbano në 2012 dhe tani boton edicionin e tretë me temën “Kodet”, me kontribut nga disa artistë dhe shkrimtarë.

Petrit Halilaj (1986) u lind në Kosterc dhe jeton në Prishtinë dhe Berlin.

Alvaro Urbano (1983) u lind në Madrid dhe jeton në Berlin.

Forget Me Not is a majestic fabric flower installation created under the cupola of the National Library of Kosovo, an archive of collective memory and knowledge. Each flower in the constellation—be it forsythia, palm seeds, cherry blossom, quince, or carnation—embodies, alongside the flowers' monumental beauty, a connotation from the artists' personal histories and relations. They also demarcate where personal memory—the lived experience within—carries the potential to progressively rewrite and reform collective memory. The flowers stand for all forms of love, desire, intimacy, kinship, and identity, but especially for those that are neglected or repressed by regressive politics and social norms.

The flowers were first exhibited in Madrid in Spain, a country that does not recognize the independence of Kosovo and is therefore very difficult for Kosovars to enter. They come to Prishtina, in collaboration with the 5th Annual Pride Week in Kosovo, as a site-specific installation with a special mission. *Forget Me Not* reinforces the Kosovar civic campaign for equal rights, particularly for the LGBTQI+ community, which demands that the new civil code include the right to marry. It empowers the campaign with floral beauty—now also as its official image. The Constitution of Kosovo, created in 2008 and inspired by progressive and egalitarian values, opens the possibility of partnership and adoption for LGBTQI+ people, but the civic code does not yet match the Constitution's values.

The installation is accompanied by the third edition of the zine *Kushtetuta*, initiated by Halilaj and Urbano in 2012, on the topic of codes, with contributions by several artists and writers.

Petrit Halilaj (1986) was born in Kosterc and lives in Prishtina and Berlin.

Alvaro Urbano (1983) was born in Madrid and lives in Berlin.

3.AUTOSTRADA BIENNALE

WHAT IF A JOURNEY...

P R I Z R E N

17.07–
11.09.2021

Ndiqui ekspozitën përgjatë lumit Lumbardh përmes qytetit të Prizrenit. Ajo shtrihet përgjatë asaj linje gurgulluese, ngulitur në shtëpi tradicionale dhe të reja, çati, brigje lumi, rrugica, punëtori dhe monumente të rrënuara. Ndërtesat gjysëm të ndërtuara, vrimat e padukshme dhe kurthet e përditshme zbulojnë vetveten—më shumë se sa të jenë shenja të dështimit, janë ftesë për reciprocitet të domosdoshëm, një kërkim kritik për paplotësinë, çaste të dendura ku intimiteti dhe infrastruktura takohen. Sepse, ajo që mund të vazhdojë të rritet është ajo që organikisht është e papërfunduar. Dhe ajo që ka përfunduar në rrugën e progresit është përgjithësisht e shterruar.

Në udhëtimin tonë të parë kërkimor në Prizren, në vjeshtën e vitit 2020, ne dëgjuam histori që nevojiteshin të dëgjoheshin: nga artistë, organizatorë, etnologë të ushqimit, një aktivist rom, një konservatore të trashëgimisë, një sociolog urban dhe një filozof, ndër shumë të tjerë.

Ekspozita është përgjigjja jonë ndaj atyre historive, një propozim për bashkëbisedim ndërmjet mikpritësit e të ftuarit, ku takohen dy skajet e një rruge, duke lidhur vendoren dhe të mërguarën.


Follow the exhibition along the Lumbardhi River through the city of Prizren. It spreads along that murmuring line, embedded in traditional and new houses, rooftops, river banks, alleyways, workshops, and removed monuments. Half-built buildings, invisible holes and everyday traps reveal themselves—rather than being signs of failure, they are an invitation for a necessary reciprocity, a critical search for incompleteness, dense moments where intimacy and infrastructure meet. Because what can continue to grow is what's organically unfinished. And what is finished in the course of progress is generally exhausted.

In our first research trip to Prizren in the fall of 2020, we listened to stories in need of being heard: from artists, organizers, food ethnologists, a Romani activist, a heritage conservator, an urban sociologist, and a philosopher, among many others.

The exhibition is our response to those stories, a proposal for a conversation between a host and a guest, where two ends of a road meet, connecting the local and the diasporic.

Ndërsa ecni më poshtë anës së lumit, do të hasni vepra arti për ndërprerjet, planet e papërfunduara, histori të fshira, ardhje të papritura dhe largime të vonuara; do të ndërveproni me tuba dhe shina—fragmente dëshirash dhe mënyra për të mirëmbajtur jetën—me mënyrën se si ne ndërtojmë infrastrukturën dhe infrastrukturën që na ndërton neve.

As you walk further down the river you will come across artworks about ruptures, unfinished plans, erased histories, sudden arrivals, and delayed departures; you will interact with pipes and tracks, fragments of desires and ways of maintaining life, with the way we build infrastructure and infrastructure builds us.





(H P)

HIDROELEKTRANA
PRIZRENASJA/
PRIZRENASJA HYDRO
POWER PLANT

PRIZREN-PREVALLE, 2.5 KM

AGNIESZKA POLSKA

BORA BABOÇI

KOSOVO
ELECTRIFICATION
MAP

Historia e Hidroelektranës Prizrenasja është e lidhur ngushtë me historinë e elektrifikimit në Kosovë. Ndërtesa ndodhet në pjesën lindore të Prizrenit dhe paraqet një nga hidrocentralet e para të ndërtuara në vend. E ndërtuar në vitin 1929, ndërtesa ka furnizuar qytetin me energji elektrike për dyzet e katër vjet. Furnizimi me energji elektrike ka ndikuar në hapjen e kinemasë së parë në qytet dhe zhvillimin e zanateve të reja të tilla si priza druri, zile dere, dhe transformatorë të vegjël. Hidrocentrali furnizonte institucionet publike, banesat e njerëzve të pasur, mullinjtë dhe njësitë tregtare. Për shkak të mungesës së kapacitetit dhe pajisjeve të vjetëruara, hidrocentrali ndaloj së funksionuari në vitin 1973.

Në vitin 1975, ndërtesa u adaptua në Muzeun e Historisë Elektrike të Kosovës. Ajo u restaurua dhe u inagurua si muze në vitin 1979. Procesi i adaptimit të një ndërtese industriale në muze përfaqëson një vetëdije të lartë shoqërore për vlerën e të gjitha ndërtesave të trashëgimisë kulturore, jo vetëm të atyre fetare.

The story of Prizrenasja Hydro Power Plant is closely tied to the history of electrification in Kosovo. It is located in the eastern part of Prizren and was one of the first hydropower plants built in the country. Built in 1929, it supplied Prizren with electric energy for forty-four years. It led to the opening of the first cinema and the development of new crafts such as wooden plugs, doorbells, and small transformers. The hydropower plant supplied public institutions, wealthy homes, mills, and commercial entities. Due to a lack of capacity and aging equipment, the hydropower plant stopped functioning in 1973.

In 1975, the building was adapted into the Museum of the Electrical History of Kosovo. It was restored and inaugurated as a museum in 1979. The process of converting an industrial building into a museum represents a social awareness of the value of all cultural-heritage buildings, not only the religious ones.



AGNIESZKA POLSKA

THE THOUSAND-
YEAR PLAN/
PLANI MIJĘVJEČAR

2021

Plani Mijëvjeçar është një instalacion filmik gjithëpërfshirës. Historia është vendosur në vitet e para të Polonisë së pas Luftës së Dytë Botërore, dhe përqendrohet në dy grupe shoqërore shumë të ndryshme: inxhinierët e përfshirë në krijimin e rrjetit të energjisë në fshat—përfaqësuesit e shtetit të hershëm komunist, e grupi tjetër janë partizanë antikomunistë, partizanë nacionalistë, ende duke u fshehur në pyll pas përfundimit të luftës. Takimi i tyre i papritur shërben si një arsye për një reflektim poetik mbi rëndësinë politike të organizimit të megastrukturave teknologjike. Filmi kombinon video të animuara dhe pamje reale. Vepra prezanton mënyrën se si zhvillimi i elektrifikimit të rrjeteve të energjisë dhe megastrukturave teknologjike krijoi arkitekturën qeverisëse planetare. Ajo reflekton se si marrëdhënia tekniko-njerëzore u shndërrua në një dinamikë në të cilën njerëzit nuk jetojnë pranë teknologjisë, por më shumë brenda saj, në një organizëm sferik, teknologjik. Me një rrëfim poetik dhe redaktim të veçantë, vepra përqendrohet në aspekte të ndryshme të zhvillimit të rrjetit elektromagnetik: rolin e tij si hartë e fuqisë socio-ekonomike, si mjet për kontrollim, si faktor emancipues, si vend për shpirtëroren, si arkitekturë për vetëdijen moderne dhe më vonë për epokën e informacionit.

Filmi filloi me interesimin e Polskës për zhvillimin e rrjetit të energjisë në kontekstin e Polonisë së hershme komuniste, dhe në të ardhmen do të zgjerohet me kapituj të vendosur në kohë dhe vende të ndryshme, dhe rrjete të ndryshme të elektrifikimit. Në Prizren, vepra shfaqet pranë hartës së vjetër të elektrifikimit të Jugosllavisë, në një vend ku uji u kthye në energji dhe më pas në dritë.

Agnieszka Polska (1985) ka lindur në Lublin dhe jeton në Berlin.

The Thousand-Year Plan is an immersive, filmic installation. The story is set in the first years of post-World War II Poland and focuses on two very different social groups: the engineers involved in establishing the power grid in the countryside—the representatives of the early communist state—and the anti-communist, nationalist partisans, still hiding in the forest after the end of the war. Their unexpected encounter serves as a reason for a poetic reflection on the political importance of the organization of technological megastructures. The film combines animated and live-action video. It presents how the electrification development of power grids and technological megastructures created governing planetary architecture. It reflects on how the techno-human relationship evolved into a dynamic in which humans don't live next to technology, but rather inside it, in a spherical, technological organism. With a poetic narrative and shattered edit, the work focuses on various aspects of the development of the electrical grid: its role as a map of socioeconomic power, a tool for control, an emancipating factor, a placeholder for spirituality, an architecture for modern consciousness and later the Information Age.

The film began with Polska's interest in the development of the power grid in the context of early communist Poland, and in the future it will expand with the chapters set in different times and places, and different electrification nets. In Prizren it is featured next to the old map of the electrification of Yugoslavia, in a place where water was turned to power, which was then turned to light.

Agnieszka Polska (1985) was born in Lublin and lives in Berlin.



BORA BABOÇI

THE WATERS OF
PRIZREN

2021

PREDICTIONS

2020

Në Prizren është një thënie: “Kur e çon një shkëmb, rrjedh uji”. Ujërat lokalë të qytetit janë të gjithë ujëra të pijshëm. Dy rrugët kryesore ujore ushqejnë qytetin, njëra prej të cilave quhet Katërdhjetë Bunarët. Në një udhëtim kërkimor në Prizren, artistja dhe arkitektja Bora Baboçi vizitoi vendet e sistemit të furnizimit me ujë dhe takoi kujdestarët e tyre. Disa burime ndodhen në shpella pranë shpatit të malit, të tjera në malet përreth qytetit, e disa të tjera janë nënujore. Vepra akustike që ka rezultuar, si dhe gouache dhe vizatime të bëra në terren, janë raporti i këtij udhëtimi. Është një homazh për ujin dhe lumin që përvijon dhe ushqen qytetin, por është gjithashtu një thellim në infrastrukturën rrjedhëse komplekse të tyre. Vepra gjarpëron mes kuptimit të ujit si burim i jetës, ujit si e mirë e përbashkët, dhe kanaleve të tij shpërndarëse arkaike dhe bashkëkohore. Ndërsa ecë ose ulesh në kopshtin Hidroelektrana do të dëgjosh tinguj të turbinave, motorëve, rrjedhës së tejmbushur. Krahës rrymës së Lumbardhit do të dëgjosh gjithashtu një lum tjetër—të trazuar dhe të paparashikueshëm—lumi Shannon në Limerick, Irlandë, një nga lumenjtë e shumtë në qarkullimin planetar të ujit, duke u mirëmbajtur jetën, kudo që jemi.

Bora Baboçi (1988) ka lindur në Tiranë dhe jeton në Shkodër.

In Prizren there is a saying: “When you lift a rock, water flows.” The local waters of the city are all drinking waters. Two main waterways feed the city, one of which is called Forty Sources. On a research trip to Prizren, artist and architect Bora Baboçi visited the locations of the water supply system and met their guardians. Some sources are situated in caves by the mountain slope, others in mountains surrounding the city, some others underwater. The resulting acoustic piece is a report from this trip. It is a tribute to water and the river that outlines and feeds the city, but it is also an insight into its complex, flowing infrastructure. The piece meanders between the meaning of water as a source of life, water as a commons, and its archaic as well as contemporary distribution channels. As you sit in the garden of the power plant you will hear sounds of the turbines, engines, overflows. And next to the current of the Lumbardhi you will also hear another river—a turbulent and unpredictable River Shannon in Limerick, Ireland, one of many in the planetary water circulation that maintains life wherever we are.

Bora Baboçi (1988) was born in Tirana and lives in Shkodra.



KOSOVO
ELECTRIFICATION MAP/
HARTA E
ELEKTRIFIKIMIT
TË KOSOVËS

1978-79

Kur Hidroelektrana Prizrenasja u shndërrua në Muzeun e Historisë Elektrike të Kosovës, një ekspozitë e përhershme u konceptua dhe u krijua për të përfaqësuar zhvillimin e ekonomisë elektrike në Kosovë. Një vepër unike dhe e rrallë e kësaj ekspozite është Harta e Elektrifikimit të Kosovës. Harta e përgatitur në reliev gjeografik, u prodhua nga Drejtoria Gjeodetike Ushtarake në Beograd gjatë viteve 1978-1979. Harta, në formë drejtkëndëshe, është bërë duke përdorur allçi, me pikat e gjenerimit dhe transmetimit të energjisë elektrike të lidhura manualisht me fije. Harta e Elektrifikimit është shembulli i dytë i këtij lloji të hartës, e para është Harta Arkeologjike e punuar për Muzeun Arkeologjik në Prizren.

Muzeu i Historisë Elektrike të Kosovës u hap në 1979 për të shënuar pesëdhjetë vjetorin e themelimit të Hidroelektranës. Konceptualizimi i muzeut, së bashku me adaptimin e ndërtesës dhe përgatitjen e ekspozitës së përhershme, ishte rezultat i vizionit dhe punës së palodhshme të të ndjerit Muhamed Shukriu, drejtori i Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve dhe Rrariteteve Natyrore në Prizren.

Ndërtesa u restaurua në 2012, por artefaktet e muzeut dhe ekspozita nuk arritën të përfundojnë në kuadër të fazës së parë të restaurimit. Harta është degraduar nga vitet dhe mungesa e mirëmbajtjes dhe ka nevojë për konservim.

When Hidroelektrana Prizrenasja was transformed into the Museum of Electrical History of Kosovo, a permanent exhibition was conceptualized and designed to represent the development of the electrical economy in Kosovo. A unique and rare piece of this exhibition is the Kosovo Electrification Map. The map, prepared in geographical relief, was produced by the Military Geodetic Directorate in Belgrade between 1978 and 1979. The map, rectangular in shape, was made using stucco, with the points of electricity generation and transmission connected by threads. The Electrification Map is the second example of this type of map, the first being an archaeological map designed for the Archaeological Museum in Prizren.

The Museum of Electrical History of Kosovo opened in 1979 to mark the fiftieth anniversary of the plant. The conceptualization of the museum, together with the building adaptation and the preparation of the permanent exhibition, was the vision and work of the late Muhamed Shukriu, the director of the Institute for Protection of Monuments and Natural Rarities in Prizren.

The building was restored in 2012, but the museum's objects and permanent exhibition were not included in the preservation effort. The map has degraded due to age and lack of maintenance and is in need of conservation.



(P M)

MULLIRI I
PINTOLLIT/
PINTOLLI MILL

RRUGA VATRAT SHQIPTARE

HAVEIT

Mulliri i Shotmanit, i njohur sot gjithashtu si Mulliri i Pintollit, u rindërtua në fillim të vitit 2000 sipas gjurmëve të mullirit të vjetër. Ky mulli paraqet njërin prej mullinjve të paktë që kanë mbijetuar në qytet. Rreth viteve 1950 në Prizren, shtriheshin pesëmbëdhjetë mullinj aktivë pranë lumit. Sot, mulliri funksionon si një kafene, por në brendi janë ruajtur elementet origjinale të cilët shërbenin për funksionim të tij: gurët për bluarjen e grurit, elementet prej druri për klasifikimin e grurit dhe kanalet prej guri ku rrjedh uji i cili depërton nën ndërtesë dhe vazhdon të derdhet në lumë.

The Shotman Mill, today also known as the Pintolli Mill, was reconstructed in early 2000 according to the traces of the original. It represents one of the few mills that has survived in the city—in 1950 there were fifteen active mills near the river. Today, the mill functions as a café, but the original elements have been preserved: the stones for grinding the wheat, the wooden elements for wheat classification, and the stone channels through which the water penetrated the building and continued into the river.



HAVEIT

CEYLON ISLAND

2016

HAVEIT është një kolektiv i përbërë nga dy palë motra (dy çifte motrash) të cilat realizojnë performanca publike për ta trajtuar mbipërfaqësimin e burrave në hapësirën publike, për të protestuar kundër dhunës ndaj grave dhe për të promovuar ndryshime shoqërore, humor, pohime dhe emancipim. Kolektivi ekziston që nga viti 2011. Së bashku, vajzat vazhdimisht dhe në mënyrë elegante shprehin pakënaqësi duke bërë veprime si larja e sutjenave dhe të brendshmeve në një nga fontanat e Prishtinës ose organizimi i një puthje publike mes dy grave, respektivisht mes katër vajzave të grupit. Në kafenen Mulliri i Pintollit, ato ekspozojnë fotografi, duke reflektuar vizitat e tyre në çajtoret tradicionale të Prizrenit. “Pirja e çajit të zi ka qenë gjithmonë një pjesë integrale e jetës sonë”, shpjegojnë artistet. “Ne fillojmë të pimë çaj dhe mësojmë si ta bëjmë dhe ta shërbejmë atë që nga fëmijëria. Shërbimi i çajit për prindërit është detyra e çdo vajze. Ndërsa e bëjmë, e shërbejmë dhe e pimë çajin në shtëpitë tona, nuk mund ta bënim këtë rehatshëm në çajtore, pasi ato janë kryesisht të mbushura me burra.” Fotografitë, ku shfaqen katër artistet me veshje shumëngjyrëshe, duke marrë kohën dhe hapësirën e tyre në kafenetë e mbizotëruara nga burrat, kthejnë vështrimin dhe pyesin se si hapësira publike mund të jetë njëjtë e përshtatshme edhe për gratë. Ekspozita shoqërohet me një performancë gjatë fundjavës së hapjes.

HAVEIT is a collective comprised of two pairs of sisters who stage public performances in order to tackle the overrepresentation of men in public space, to “make [their] lives less boring,” to protest violence against women, and to promote social change, humor, affirmation, and emancipation. The collective has existed since 2011. Together they consequently and elegantly voice discontent by making actions like washing their bras and underwear in one of Prishtina’s fountains or staging a public kiss between two women. At the café at Pintolli Mill, they exhibit photographs, reporting on their visits to the traditional tea houses of Prizren. “Drinking black tea has always been an integral part of our lives,” explain the artists. “We start drinking tea and learning to make and serve it when we’re just children. Serving tea to your parents is every girl’s duty. While we make it, serve it, and drink it in our homes, we could not comfortably do so in tea houses, as they are predominantly occupied by men.” The photos, featuring the four women in colorful clothing taking their time and space in male-dominated cafés, reverse the gaze and ask how public space could be more accommodating to women, how it could be more “female.” The exhibition is accompanied by a performance during the opening weekend.

HAVEIT, a collective based in Prishtina, was founded in 2011.



(A L)

LIDHJA E
PRIZRENIT/
ALBANIAN LEAGUE
OF PRIZREN

SHESHI I LIDHJES

AGRON BLAKÇORI

VALBONA ZHERKA

Kompleksi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit është një ansambël arkitektonik urban, i vendosur në qendrën historike të qytetit. Më 10 qershor 1878, këtu u zhvillua takimi që shënoi fillimin e luftës politike dhe kulturore kundër Perandorisë Osmane. Kjo datë shënon apelin zyrtar në Kongresin e Berlinit, me kërkesën për një shtet shqiptar. Kompleksi ndodhet në bregun perëndimor të lumit Lumbardh. Ndërtesat e këtij kompleksi kanë qenë pjesë e ansamblit arkitektonik të xhamisë Gazi Mehmet Pasha, ku përfshihej medreseja (shkolla) dhe mejtepi (biblioteka). Me rastin e shënimit të 100 vjetorit të kësaj ngjarje historike, kompleksi u adaptua dhe u shndërrua në muze. Në ndërtesën e bibliotekës gjendet sektori i historisë, ku janë të ekspozuar figurat historike dhe dokumente të vjetra që ndërlidhen me ngjarjen. Në medrese gjendet sektori etnografik, ku janë ekspozuar artefakte etnografike nga shekulli i nëntëmbëdhjetë dhe i njëzetë, si dhe në galeri ekspozita e veprave dedikuara ngjarjes historike të themelimit të Lidhjes Shqiptare. Ndër veprat tjera, në galeri shfaqen edhe dy vepra nga artistja Valbona Zherka: *Qëndresa*, 1978 dhe *Kullat e Qëndresës*, 1978. Veprat janë restauruar për herë të parë nga artistja, për edicionin e tretë të Autostrada Biennale.

The Compound of the Albanian League of Prizren is an urban architectural ensemble located in the historic city center. It is where, on June 10, 1878, the meeting that marked the start of the political and cultural struggle against the Ottoman Empire took place. This date marks the official appeal to the Berlin Congress for an independent Albanian state. The compound is situated on the western bank of the Lumbardhi. Its buildings were formerly part of the architectural ensemble of Gazi Mehmet Pasha Mosque, including the school and library. To mark the hundred-year anniversary of the event, the compound was adapted and transformed into a museum. The small library is home to a display on historical figures and of old documents. The former school features a display of ethnographic artifacts from the nineteenth and twentieth centuries as well as an exhibition dedicated to the historical event of the founding of the Albanian League. The gallery displays, among other pieces, two works by Valbona Zherka: *Resistance* (1978) and *Towers of Resistance* (1978). The pieces have been restored for the first time by the artist for the third edition of the Autostrada Biennale.



AGRON BLAKÇORI

DEMOCRACY/
DEMOKRACIA

2021

Agron Blakçori ka jetë paralele skulpturore. Ai angazhohet dhe e komisionojnë artistikisht në vepra për figurat politike dhe kulturore të Kosovës, siç është monumeti i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit; por ai gjithashtu bën instalacione skulpturore përmbyesë nga materialet e përditshme që ai i merr dhe i riciklon për të krijuar shënime në lidhje me mënyrat aktuale të mbijetesës. Njëra anë e plotëson tjetrën. Gjestet e tij janë të thjeshta, të mprehta dhe drejtë në temë. Për Autostrada Biennale, Blakçori ka realizuar një projekt që ai e ka pasur në mendje për një kohë të gjatë: *Demokracia*, përbërë nga tre rrathë me karrige shkollore nga druri, të kthyera përmbyes në kopshtin rrethor të Lidhjes Shqiptare. Vepra propozon një kritikë realiste të mekanizmave jofunksionale të vendimmarrjes lokale dhe ndërkombëtare që kanë për qëllim krijimin e një baze të përbashkët për të mirën publike. Vepra është një refuzim; ajo kundërshton normalizimin e jetës kaotike të demokracisë në Kosovë, ndryshimet e vazhdueshme të përfaqësuesve në parlament dhe qeveri, mungesën e stabilitetit, dhe korrupsionin. Materiali i veprës adreson rrënjën e problemit—arsimin—dhe u jep qytetarëve agjenci për zgjidhjen e tij. *Demokracia* është e mbarsur me humor të errët, por nuk është pesimiste. Të kthesh karriget me kokë poshtë, të ulesh mbi to dhe të marrësh përgjegjësi për një të ardhme tjetër, është e mundur.

Agron Blakçori (1981) ka lindur në Podujevë dhe jeton në Prishtinë.

Agron Blakçori has parallel sculptural lives. He makes major public commissions about political and cultural figures of Kosovo, such as the monument at the Albanian League of Prizren; but he also makes subversive sculptural installations from everyday materials that he picks up and recycles to create footnotes about current ways of survival. One side complements the other. His gestures are simple, sharp, and to the point. For Autostrada Biennale, Blakçori has realized a project that has been on his mind for a long time: *Democracy*, which is made of three circles of wooden school chairs turned upside down in the circular garden of the Albanian League. The work proposes a down-to-earth critique of the dysfunctional local and international decision-making mechanisms that are meant to create a common ground for the public good. The piece is a refusal; it rejects normalizing the rollercoaster life of democracy in Kosovo, the constant changes in parliament and government representatives, the lack of stability, and corruption. The material of the work addresses the root of the problem—education—and gives agency to the citizens to resolve it. *Democracy* is imbued with dark humor, but it is not pessimistic. To turn the chairs upside down, to sit on them and take responsibility for another future, is possible.

Agron Blakçori (1981) was born in Podujeva and lives in Prishtinë.



VALBONA ZHERKA

RESISTANCE/
QËNDRESA

RESISTANCE TOWERS/
KULLAT E QËNDRESËS

1978

Valbona Zherka lindi në Prishtinë në vitin 1955. Ajo diplomoi në Akademinë e Arteve të bukura në vitin 1977 dhe më pas vazhdoi studimet në Beograd. Ajo punon me tapiceri dhe është frymëzuar nga kultura popullore, teknikat tradicionale, çështjet shoqërore, të drejtat e grave dhe e drejta e vetëvendosjes. Megjithatë, nuk ka qenë e lehtë për të si një artiste grua. Anipse puna e saj u ekspozua në vitet 1970 dhe 1980—në Sarajevë, Maribor, Beograd, Zagreb, Prishtinë dhe në ekspozitën “Gratë Krijuese të Jugosllavisë”, ku ishte e vetmja pjesëmarrëse nga Kosova—ajo ishte shpesh e marginalizuar dhe puna e saj u hoq nga kanuni i artit. Kur, në fillim të viteve 1990, ajo aplikoi për një punë si profesoreshë në Akademinë e Arteve të bukura, portofolio e saj, bashkë me një numër të veprave të saj, humbën përgjatë procesit.

Pikënisje për një retrospektivë të vogël të punimeve të saj në Autostrada Biennale janë dy vepra në formë tapicerie, të instaluar në Kompleksin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, *Qëndresa* dhe *Kullat e Qëndresës*, të dyja datuar nga viti 1978. Ato janë restauruar dhe një pjesë e munguar e tryptikës është krijuar veçmas për bienale, me titullin *Shpresa*. Artistja shprehet: “Jam e preokupuar me jetën në mes të së cilës jetoj, një e kaluar plot ngjarje që pret vetëm të shndërrohet në një vepër arti.” E nganjëherë veprat e artit duhet të presin—Zherka është shpesh e zënë si mësimdhënëse, menaxhere e projekteve të ndryshme, koordinatorë e terapisë profesionale, punonjëse sociale dhe redaktore.

“Përderisa rrugëtojmë, shpresojmë”, thotë ajo. Grumbulli i saj i endur në *Shtegtimi*, i rrugëve të mbivendosura dhe shtigjeve të migrimit ofroi një hartë orientimi për tërë Bienalen, me një metaforë të shpresës në një udhëtim i cili nuk përfundon kurrë, dy skajet e rrugëve që takohen në mes jetës diasporike dhe asaj lokale.

Valbona Zherka (1955) ka lindur dhe jeton në Prishtinë.

Valbona Zherka graduated from the Prishtina Academy of Fine Arts in 1977 and continued with her studies in Belgrade. She works with tapestry and is inspired by popular culture, traditional techniques, social issues, women’s rights, and the right to self-determination. Yet it has not been easy for her as a woman artist. Although her work was shown in the 1970s and 1980s—in Sarajevo, Maribor, Belgrade, Zagreb, Prishtina, and at the “Creative Women of Yugoslavia” exhibition, where she was the only woman from Kosovo—she was still often marginalized and her work omitted from the art canon. When, in the early 1990s, she applied for a professorship at the Academy of Fine Arts, her portfolio, along with a number of her tapestry works, were lost in the process.

The departure point for a small retrospective of her works at Autostrada Biennale are two tapestry pieces, installed at the Albanian League Museum: *Resistance* and *Resistance Towers*, both from 1978. They have been restored, and a missing part of the tryptic has been created for the occasion, entitled *Hope*, installed at the hammam. The artist states: “I am preoccupied with life in the midst of which I live, a past full of events that just waits to be turned into a work of art.” And sometimes artworks have to wait—Zherka is often busy as a teacher, project manager, coordinator of occupational therapy, social worker, and editor.

“As long as there is a journey, there is hope,” she states. Her woven cluster in *Migration* (installed at the hammam) of overlapping roads and migration paths offered an orientation map for the whole biennale, with a metaphor of hope in a journey, which is never completed, two ends of the roads meeting between diasporic and local life.

Valbona Zherka (1955) was born in Prishtina and lives in Prishtina.



(U C)

NËN SHKËMBINJTË
E KALASË / UNDER
CASTLE CLIFFS

HERA BÜYÜKTAŞCIYAN

Shkëmbinjtë e vendosur në kodrën e Nën Kalasë, ndodhen në anën veriore të Kompleksit Marash. Kodra shkëmbore mbi të cilën shtrihet Kalaja, krijon një kontrast ndërmjet strukturës së ndërtuar urbane, dhe asaj natyrore, dhe zë një pozitë qendrore të dukshme. Shkëmbinjtë kanë qenë pjesë e qytetit për shekuj me rradhë dhe kanë qenë dëshmitar të gjitha ngjarjeve historike nëpër të cilat ka kaluar qyteti—duke e ndarë gëzimin dhe dhimbjen dhe gjithçka në mes.

The Under Castle Cliffs are located on the north side of the Marash Complex. There is no path that leads there, but as they are positioned between the castle and the center of the city, they are highly visible. The cliffs have been part of the city for centuries and have seen everything that the city has gone through—the joy and the pain and everything in between.



(L W C)

KANALET E UJIT
TË LUMBARDHIT/
LUMBARDHI WATER
CHANNELS

HERA BÜYÜKTAŞCIYAN

Nga rrjedha e lumit Lumbardh janë degëzuar katër kanale të ujit, të cilët janë shtrirë në gjithë qytetin. Kanalet kryesore janë degëzuar në përrocka më të vogla duke sjellë ujë në çdo shtëpi të Prizrenit. Ky rrjet kanalesh krijonte një lidhje mes çdo lagje me lagje, kopshte me kopshte, qytetin dhe mjedisin dhe vazhdonte të derdhej në fusha. Sipas hartave dhe dokumenteve të vjetra kadastrale, në qytet ekzistonin pesë kanale kryesore: kanali Marash, Sozi, Kasim Beu, Kukli-Beu dhe Beg-Zade. Pas gjysmës së dytë të shekullit XX, zhvillimet urbane dhe ekonomike u pasuan nga ndërtimi i sistemit modern të furnizimit me ujë, duke ndërprerë rrjetin natyror të kanaleve të ujit, e përfundimisht duke ndikuar në zhdukjen e tyre graduale. Sot, kanalet e ujit mund të shihen në trajtë të fragmentuar në hapësirat brenda qendrës historike të Prizrenit.

Four water channels branch from the Lumbardhi and spread throughout the city. The channels used to branch into smaller ones to carry water into every house in Prizren. This network of channels connected neighborhood with neighborhood, garden with garden, the city and the environment, and continued to flow to the fields. The water supply network had multiple functions: for field irrigation, as a power supply (for the mills), and for household use (both for drinking water and hygiene). According to old cadastre maps and documents, there were five main channels: Marash, Sozi, Kasim-Beu, Kukli-Beu, and Beg-Zade. After the second half of the twentieth century, urban and economic developments were followed by the construction of a modern water supply system, interrupting the natural network of water channels, ultimately affecting their gradual disappearance. Today, the water channels can be found only in fragmented openings inside the historic center.



HERA BÜYÜKTAŞCIYAN

MY EYE'S PUPIL
IS YOUR NEST/
BEBËZA E SYRIT TIM
ËSHTË ÇERDHJA JOTE

2021

Bebëza e syrit tim është çerdhja jote i ripërshkon mbetjet e lumenjve mendor (ose kujtesën e përbashkët ujore). Ajo i ndjek burimet e humbura dhe arkitekturën e ujit në Prizren, duke u endur në të gjithë qytetin nga lart, përmes një linje imagjinare uji. Cituar nga një mbishkrim arab nën një afresk në Kishën e Zojës Sonë së Ljevis (e njohur në shekullin XV si Cuma Camii), “Bebëza e syrit tim është çerdhja jote” është një varg që e adreson jo vetëm veprimin e gdhendjes dhe ngulitjes së një imazhi pothuajse në zhdukje e sipër në kujtesën e dikujt, por edhe aktin e të parit përtej të padukshmes. Duke e marrë lumin, një element thelbësor që shenjon tokën, vepra përdor aktin e vizatimit për të hartëzuar sërish një shteg imagjinar uji. E përcjellë rrjedhën e paparë të ujërave të hershme, frymëzuar nga degët e lumenjve të Kasem Begut, Kukli Begut, Suzi Begut, Begzades dhe arkitekturës së potokut—kanale lineare që kalojnë përmes një shtëpie në tjetrën, kryesisht kanale të varrosura ose të zhdukura për shkak të këputjeve historike dhe politike dhe transformimit urban, në veçanti pas vërshimeve në qytet në vitin 1957. Vepra e Büyüктаşciyanit është një gjest i thjeshtë, i ngarkuar dhe i bukur i rivizatimit: një rrjet ndërtimi i kaltërt lidh kulme, duke kaluar nëpër lagje në një fije lineare—një vijë virtuale uji, që vizualisht ankoron nga njëra te tjetra. E dukshme dhe e padukshme bashkëjetojnë përmes arkeologjisë së kujtesës dhe harrimit, si natyra e ujit që njëkohësisht zbulon dhe fshehet, përderisa rrjedh.

Hera Büyüктаşciyan (1984) ka lindur dhe jeton në Stamboll.

My Eye's Pupil Is Your Nest retraces the remnants of mental rivers (or collective aquatic memory). It follows the lost springs and water architecture of Prizren by meandering throughout the city from above via an imaginary water line. Quoted from an Arabic inscription beneath a fresco at the Church of Our Lady of Ljeviš in Prizren (known in the fifteenth century as Cuma Camii), “My eye's pupil is your nest” is a verse that addresses not only the act of engraving the imprint of an almost-disappearing image onto one's memory, but also the act of seeing beyond the invisible. Taking the river, an essential element that marks land, the piece uses the act of drawing to remap an imaginary water path. It follows the unseen flow of early waters inspired by the river branches of Kasem Beg, Kukli Beg, Suzi Beg, Begzade, and the river architecture—linear channels passing through one home to the other, mostly buried or disappeared due to historical and political ruptures and urban transformation—in particular after the city's flooding in 1957. Büyüктаşciyan's work is a plain, loaded, and beautiful gesture of redrawing a blue construction net connects roofs, passing through a neighborhood in a linear thread—a virtual water line that visually anchors one to another. The seen and the unseen coexist through the archaeology of remembrance and forgetting like the nature of water that both reveals and hides as it flows.

Hera Büyüктаşciyan (1984) was born in Istanbul and lives in Istanbul.



(R B)

SHTRATI I LUMIT/
RIVER BANK

AGNES DENES

Në bazë të dokumenteve arkivore kuptohet se qyteti i Prizrenit ka filluar të zhvillohet rreth dy anëve të brigjeve të lumit Lumbardh, i cili përkon qytetin përgjatë aksit lindje—perëndim, duke e ndarë atë në dy pjesë. Lumi ka shërbyer si arterie kryesore për zhvillim të jetës në këtë qytet, dhe uji që rrjedhte me shpejtësi ka kontribuar në pastërtinë dhe veçoritë urbane të tij.

Brigjet e lumit paraqesin hapësirat më të mëdha publike brenda qendrës historike të Prizrenit. Ata janë përdorur në mënyra të ndryshme gjatë viteve: gjatë viteve të 70-ta të shekullit të kaluar, niveli i lartë i ujit ka mundësuar që njerëzit të notojnë aty. Gjatë 20 viteve të fundit, shtrati dhe brigjet e lumit kanë mirëpritur aktivitete të shumta kulturore dhe festivale unike.

Historical documents show that Prizren was developed and spread around the two banks of the Lumbardhi, which divides the northern part of the city from the southern. The river acted as the main artery for development, and its rapidly flowing water contributed to the cleanliness of the city.

The river banks are the biggest public space within the historic center of Prizren. They have been used in multiple ways throughout the years: in the 1970s, high waters allowed people to swim from the banks, and more recently, in the past twenty years, the banks have hosted cultural activities and festivals.



AGNES DENES

SUNFLOWER FIELDS/
FUSHAT E LULEDIELLIT

2021

“Për lulediellin u interesova së pari derisa mbillja arën time me grurë. Duke realizuar hulumtimin tim të zakonshëm në vazhdimësi, mësova se përzierja e grurit me lulediellin ndihmon për të mbajtur dheun të pasur. Më vonë kur më ftuan të shkruaj një ese në një libër për tokën, unë e përdora këtë njohuri për të prezantuar mënyra të ndryshme se si duhet ta mbajmë pjellor këtë burim të çmuar; duke alternuar mbjelljen e grurit gjatë një sezoni dhe lulediellit në sezonën tjetër do të sigurohet pjelloria e tokës. Ne e pranojmë dheun dhe nuk mendojmë shumë për ekzistencën e tij, e megjithatë e gjithë jeta varet nga kjo shtresë e hollë që e rrethon globin. Luledielli është bimë e lumtur dhe nënkupton shumë gjëra në kultura të ndryshme. Për kinezët ajo sjell fat të mirë ndërsa për fisin Incas ajo simbolizon Zotin e Diellit. Jam e lumtur që po i mbjellni këto lule, në të gjitha fushat e mundshme. Do të sjellin kënaqësi dhe mirëqenie, sikurse të gjitha gjërat që rriten dhe janë të gjalla. Kur gjërat rriten, lulëzojnë, jeta shprehë transformimet dhe sekretet e saja. Shikoni, dëgjoni dhe merrni pjesë! Ne të gjithë mund të bëhemi si luledielli—të rritemi, të ushqehemi, t’u dhurojmë të tjerëve pasurinë tonë, të kthehemi drejt Diellit, e të reflektojmë ngrohtësinë e tij të të gjitha krijesat e gjalla.”

Agnes Denes, një artiste ikonike feministe me origjinë hungareze, e cila jeton e vepron në New York, deklaroi në *Manifeston* e saj të vitit 1969, se donte ta braktiste kullën e fildishtë të studios së saj dhe të hynte në botën e shqetësimeve të vërteta globale, “duke komunikuar të pakomunikueshmen,”

Agnes Denes (1931) ka lindur në Budapest dhe jeton në New York City.

“I originally became interested in sunflowers while planting my wheat field. In doing my usual constant research I learned that alternating planting wheat and sunflowers helps to keep the soil rich. Later when I was invited to write an essay for a book about soil, I used this knowledge to impart the many ways we must keep this precious resource fertile; alternating planting wheat one season and sunflowers the next will ensure the soil’s fertility. We accept soil and think little of its existence, but all life depends on this thin layer surrounding the globe. Sunflowers are happy plants that mean many things in different cultures. For the Chinese they are good luck and for the Incas they symbolized the Sun God. I am glad you are planting these flowers, in all possible areas. It’ll bring pleasure and well-being, as do all things that grow and live. When things grow, blossom, life is expressing its transformations and secrets. Watch, listen, participate. We all can be like sunflowers—grow, nourish, endow others with our richness, turn to the sun, then reflect its warmth to all living creatures.”

Agnes Denes, an iconic, feminist, New York-based artist of Hungarian origin, declared in her 1969 *Manifesto* that she wanted to leave the ivory tower of her studio and enter the world of the global concerns, “communicating the incommunicable,” “visualizing the invisible,” “not accepting the limitations society has accepted,” and “persisting in eternal search.” Throughout her life and career she has imagined and initiated visionary experiments of cohabitation through art. Her well-known statement work *Wheatfield–The Confrontation* (1982), two

Agnes Denes (1931) was born in Budapest and lives in New York City.



“duke vizualizuar
të padukshmen,”
“duke mos i pranuar
kufizimet që shoqëria
i ka pranuar,” dhe
“duke këmbëngulur
në kërkimin e
përjetshëm.” Gjatë
jetës dhe karrierës së

saj, Denes ka imagjinuar dhe iniciuar eksperimente vizionare të bashkëjetesës përmes artit. Vepra e saj e njohur emblematike *Fushë gruri–Ballafaqimi* (1982), dy hektarë grurë të mbjellur në një deponi rrënojash të shpërndara në Manhattan pranë Wall Street, interpretoi trashëgiminë e artit të tokës dhe e shndërroi atë në një ndërhyrje ekologjike urbane, duke sugjeruar se ku do të zhvilloheshin betejat e ardhshme. Denes, ende duke prodhuar aktivisht edhe në të nëntëdhjetat, për Autostrada Biennale ka propozuar një punë të re të dy fushave me luledielli, të cilat do të mbjellen në qendër të qytetit në Prishtinë dhe Prizren. Si gjini, *Helianthus*, luledielli vjen nga fjalët greke *helios* (dielli) dhe *anthos* (një lule). Fillimisht ishte kultivuar nga kulturat indigjene, e pastaj, përmes Rusisë, bëri rrugë për në Evropë dhe më pas erdhi në Ballkan, duke u bërë bimë simbolike për Kosovën në kohën e Jugosllavisë, e cila nga atëherë pothuajse është zhdukur në tërësi. Një ndërhyrje ndjekë diellin, lulediejt rishfaqen në mes të qyteteve që përballen me ndotjen dhe gjentëfikimin, si—me fjalët e artistes—një gjest për të “parë realitetin dhe megjithatë për të qenë në gjendje për të ëndërruar”.

acres of wheat planted on a rubble-strewn landfill in Manhattan near Wall Street, interpreted the heritage of environmental art and turned it into an urban ecological intervention, suggesting where future struggles would take place. For Autostrada



Biennale, Denes, still actively producing in her nineties, proposed a new work of two sunflower fields to be planted in the centers of Prishtina and Prizren. The sunflower’s genus,

Helianthus, comes from the Greek words *helios* (sun) and *anthos* (flower). It was first cultivated by indigenous cultures, and then, through Russia, made its way to Europe and subsequently to the Balkans, becoming a symbolic plant for Kosovo in the Yugoslav era, and which has since almost vanished. An intervention that follows the sun, sunflowers reappear in the middle of cities struggling with pollution and gentrification, as—in words of the artist—a gesture of “seeing reality and still being able to dream.”



(L S)

SHESHI I LIDHJES/
LEAGUE SQUARE

ALBAN MUJA

Sheshi paraqet një kryqëzim të shtresimeve historike, të cilat datojnë nga tri periudha dhe ideologji të ndryshme: rrënojat arkeologjike nga antikiteti i vonë; minarja e mbetur e Xhamisë Arasta, që daton nga shekulli 19 dhe e cila u shkatërrua në vitin 1963; dhe një ndërtesë moderniste nga gjysma e dytë e shekullit 20, e ndërtuar në stilin modernist socialist jugosllav. Në kryqëzim të këtyre tri konteksteve gjenden mbetjet e një monumenti antifashist “Heronjtë e Popullit – Agimi i Lirisë”, i formësuar nga një kornizë drejtkëndëshe me një hapësirë rrethore në qendër. Monumenti u prezantua për publikun në 1984 për të nderuar dëshmorët e Luftës së Dytë Botërore: Xhevdet Doda, Emin Duraku, Mustafa Bakiu, Slobodan Sercevic, Jovanka Radiovojevic dhe Dragiza Nekic. Sot, statujat prej bronzi janë larguar, kurse vetëm struktura nga betoni, i ngjyrosur në të bardhë ka mbetur.

This site is an overlapping intersection of three different times and ideologies: ruins from late antiquity; a minaret from the Arasta Mosque, dating from the nineteenth century and destroyed in 1963; and a modernist building from the second half of the twentieth century, built in Yugoslav socialist-modernist style. These three contexts host the remains of an antifascist monument Heronjte e popullit – Agimi i Liris (“the heroes of the people – the dawn of freedom”), a rectangular frame with a circular void. The monument was presented to the public in 1984 to honor the World War II martyrs Xhevdet Doda, Emin Duraku, Mustafa Bakiu, Slobodan Sercevic, Jovanka Radiovojević, and Dragica Nekić. Today, the bronze statues have been removed, leaving a whitewashed structure behind.



ALBAN MUJA

MOVING MONUMENT/
MONUMENTI NË LËVIZJE

2021

“Kam lindur në Jugosllavi dhe jam rritur nën regjimin e aparteidit të Millosheviqit. Deri sa mbusha 18 vjet, kur e fituam lirinë, jetuam në një gjendje të përhershme krize.” Alban Muja u rrit në Mitrovicë me babanë artist që dizajnonte billborde dhe reklama për të mbijetuar dhe për të mbështetur familjen. Puna e tij nuk lejohej të shfaqej në institucione.

Muja ka punuar rreth fragmenteve të subjektiviteteve politike dhe shoqërore që e kanë ndërtuar atë dhe të kaluarën e tij, në përpjekje për të kuptuar tablonë e plotë nga kënde të ndryshme, duke ndërlidhur detaje të ndryshme me të tashmen, në filmat, fotografitë, pikturat, vizatimet dhe video-instalacionet. Vepra e tij e re, e punuar për Autostrada Biennale, tregon gjendjen aktuale dhe të ardhmen e monumenteve nga periudha jugosllave në Kosovë dhe mënyrat konfliktuale se si janë të ndërtuara sot hapësirat publike. Për të nxitur një diskutim aktiv publik rreth këtyre pyetjeve—që janë një brengë e madhe për shumë qytetarë kosovarë—Muja përqëndrohet në një monument të barazisë dhe përparimit, i zhdukur papritmas nga qendra e qytetit të tij të lindjes. Sot e kësaj dite, gjendja dhe statusi i monumentit mbetet i panjohur. Një kopje fantazmë tani rishfaqet në Prizren, e vendosur në piedestalin rrethor të një monamenti antifashist të solidaritetit në qendër të qytetit, që u shkatërrua gradualisht pasi Millosheviqi erdhi në pushtet. Muja planifikon ta kthejë monumentin në vendodhjen e tij origjinale në Mitrovicë.

Alban Muja (1980) ka lindur në Mitrovicë, jeton në Berlin dhe Prishtinë.

“I was born in Yugoslavia and I grew up in the apartheid regime by Milošević. Until I was eighteen, when we got our freedom, we lived in a permanent state of crisis.” Alban Muja grew up in Mitrovica with an artist father who has designed billboards and signs to survive and support his family. His work was not allowed to be shown in institutions.

Muja has been working around the fragments of political and social subjectivities that have constructed him and his past, trying to understand the whole picture from different angles, connecting different details to the present in his films, photographs, paintings, drawings, and video-installation. His new work, commissioned by Autostrada Biennale, points at the current situation and future of monuments from the Yugoslavian period in Kosovo and the conflicted ways public spaces are constructed today. To trigger an active public discussion around these questions—which are a major concern for many Kosovar citizens—Muja focuses on a suddenly disappeared monument to equality and progress that was in the center of his hometown. To this day, the status of the monument is unknown. A phantom replica now reappears in Prizren, placed on the circular pedestal of an anti-fascist solidarity monument in the city center that was gradually destroyed after Milošević came to power. Muja plans to bring the monument back to its original location in Mitrovica.

Alban Muja (1980) was born in Mitrovica and lives in Berlin and Prishtina.



(B H)

SHTËPIA E KALTËR/
BLUE HOUSE

RRUGA MARIN BARLETI

GÜLSÜN KARAMUSTAFA

Shtëpia e Kaltër është rindërtim i një shtëpie të shekullit XIX. Ndodhet në lagjen Nënkalaja, një pjesën jugore të qendrës së qytetit. Muret e shtëpisë u rindërtuan me materiale bashkëkohore, por pamja e saj tradicionale është ruajtur. Shtëpia vazhdon të shfrytëzohet si hapësirë banimi.

Blue House is a reconstruction of a nineteenth-century house. It is located in the neighborhood of Nënkalja, between the castle and the city center. The walls of the house were reconstructed with contemporary materials, but its original adobe look has been preserved. The walls of the exterior facade are blue, which is a traditional local color. The house continues to be inhabited to this day.



GÜLSÜN KARAMUSTAFA

MUHACİR/
THE SETTLER/
EMIGRANTI

2003

Gülsün Karamustafa e ka formësuar veprimtarinë e saj artistike pesë dekadëshe rreth konstruktive kombëtare, klasore dhe kulturore në Turqinë moderne. Në veçanti, ajo është përqendruar në nocionet e shtetësisë dhe agjencisë së njeriut, në tregimet koloniale, kulturat e rezistencës dhe migrimin e detyruar nga lufta. Në narrativat e saj humaniste, ajo kërkon mënyra alternative të shkrimit të historisë, shpesh herë duke u fokusuar në jetën e grave. Dedikuar të dy gjysheve të Karamustafës, *Muhacir (Emigranti)* flet për cikle të vazhdueshme të luftës dhe konfliktit, të cilat kanë shkaktuar zhvendosje të detyruar, të cilat kanë formuar peisazhin historik dhe shoqëror të Ballkanit Perëndimor. Filmi me dy kanale është frymëzuar lirshëm nga ajo që i solli familjet e gjysheve të saj në Stamboll (njëra nga Krimea përmes Bullgarisë, e tjetra nga Bosnja dhe Hercegovina e sotme) në fund të shekullit nëntëmbëdhjetë. Si një homazh për historinë e kinemasë së hershme/pa zë në Turqi, Karamustafa tregon historinë e dy grave, të fotografuara në sfondin e kartolinave të dy qyteteve, njëra me gjasë në Ballkan dhe tjetra në Anadoll, duke kaluar ngadalë mbi skajet e ekraneve, duke shkëmbyer vendet. Përderisa kartolinat janë të ngarkuara me kujtime të asaj që është lënë pas, ne na rikujtohet pamundësia e një historie lineare përballë narrativave të tilla të thyera dhe rezistencave që rriten prej tyre.

Gülsün Karamustafa (1946) ka lindur në Ankara dhe jeton në Stamboll.

Gülsün Karamustafa has shaped her five-decade-long oeuvre around national, class, and cultural constructions in modern Turkey. In particular, she has focused on notions of citizenship and human agency, colonial narratives, and cultures of resistance and migration forced by war. In her humanist narratives, she seeks alternative ways of history writing, often focusing on the lives of women. Dedicated to both of Karamustafa's grandmothers, *Muhacir (The Settler)* speaks of continuous cycles of war and conflict, which have triggered forced displacements that have shaped the historical and social landscape of the Western Balkans. The two-channel film is loosely inspired by what brought her grandmothers' families to Istanbul (one from Crimea through Bulgaria, the other from today's Bosnia and Herzegovina) in the late nineteenth century. As an homage to the history of silent/early cinema in Turkey, Karamustafa tells the story of two women, imaged against postcard backgrounds of two cities, one probably in the Balkans and the other in Anatolia, slowly crossing over the edges of the screens, swapping places. As postcards are laden with memories of what has been left behind, we are reminded of the impossibility of a linear history in the face of such broken narratives and of the resistances that grow from them.

Gülsün Karamustafa (1946) was born in Ankara and lives in Istanbul.



(C P)

KALAJA E PRIZRENIT/
CASTLE OF PRIZREN

DORUNTINA KASTRATI

IMAN ISSA

ARCHAEOLOGICAL
EXCAVATIONS
IN PROGRESS

Kalaja është një nga vendet më unike të trashëgimisë kulturore në Kosovë. Pozicioni i saj strategjik topografik, peizazhi natyror, së bashku me përbërjen e saj arkitektonike, e bëjnë atë një pikë referimi me vlera historike, artistike, shkencore, mjedisore dhe ekonomike. Kalaja gjendet në pjesën lindore të qytetit, e vendosur mbi një kodër konike. Dokumentacioni më i vjetër rreth kalasë është gjetur në *De aedificiis* (Ndërtesat), të shkruar nga kronisti bizantin Prokupi i Cezares. Ndër fortifikimet e tjera në Dardani, ky burim e përmend Kalanë e Petrizenit, prej të cilës vjen emri Prizren që e mban qyteti sot. Gërmimet arkeologjike zbuluan shtresa dhe artefakte nga epoka e bronzit të vonë, antikiteti i vonë dhe nga periudha mesjetare. Ndërhyrjet e fundit me qëllim të restaurimit dhe adaptimit, kanë shndërruar Kalanë e Prizrenit në një pikë referimi kulturor të vizituar nga mëse njëqind mijë vizitorë në vit.

The castle is one of the most unique cultural heritage sites in Kosovo. Its strategic topographical position, natural landscape, together with its architectural composition, make it a landmark with historic, artistic, scientific, environmental, and economic value. It is located in the eastern part of the city, over a conical hill. The oldest known documentation of the castle is found in *De aedificiis* (*On Construction*), written by the Byzantine chronicler Procopius of Caesarea. Among other fortifications in Dardania, the source mentions the Castle of Petrizen, the former name of Prizren. Archaeological excavations revealed depositions from the Late Bronze Age, late antiquity, and from the medieval period. A recent conservation adaptation and an almost complete reconstruction of the site made it into a cultural landmark visited by one hundred thousand visitors annually.



DORUNTINA KASTRATI

WHEN IT LEFT,
DEATH DIDN'T EVEN
CLOSE OUR EYES/
KUR U LARGUA,
VDEKJA AS QË NA
I MBYLLI SYTË

2020

There is nothing here at all.
There are no rights, no nothing.

“Vazhdova të shkoja në punë i sëmurë, me një këmbë të lënduar, dhe pastaj e lëndova përsëri në të njëjtin vend, sepse i mbaja çizmet veshur gjatë gjithë kohës. Ne punuam dymbëdhjetë deri në trembëdhjetë orë rresht; ne madje punuam edhe në ndërrime njëzet orëshe. Pa asnjë rregull fare.” Kështu rrëfen njëri nga punëtorët e industrisë së ndërtimit në Kosovë. Filmi i Doruntina Kastratit prezanton punëtorët që kanë qenë të përfshirë dhe të lënduar gjatë projekteve të mëdhaja të ndërtimeve infrastrukturore, gjë që e pasqyron koston njerëzore të tregut të pa-rregulluar të punës. Një nga pasojat kryesore është një shkallë e lartë e lëndimeve trupore, e cila më pas përjashton punën në të ardhmen në këtë industri. Shumë punëtorë deklarojnë se ata më përpara preferojnë të vdesin sesa të humbasin aftësinë për të siguruar jetesën.

Filmi i Kastratit është rezultat i një hulumtimi të gjerë, duke përfshirë dhjetëra intervista, studime të thella të dokumenteve zyrtare, dhe gërmime nëpër arkiva. Vepra u inspirua nga interesi i artistes për ndërtimin dhe ndërtesat, por në vend që ajo të fliste me inxhinierë dhe planifikues, artistja dëgjoi dëshmitë e punëtorëve që kanë humbur vendet e tyre të punës ose janë poshtëruar e gjymtuar gjatë ndërtimit të autostradave në Kosovë. Filmi shfaqë ata që janë të padukshëm: klasën e padukshme punëtore, grupin e njerëzve pa asnjë garanci apo mbrojtje ligjore në kushte kuazi-feudale të shfrytëzimit ekstrem. Filmi shpalosë tregime për punëtorët që vdiqën, humbën sytë apo duart e tyre dhe mbetën me aftësi të kufizuara për pjesën tjetër të jetës së tyre, teksa punonin për 70 cent në orë për dy kompani lidere globale, Bechtel dhe Enka—të dyja poashtu mbrojtëse të artit bashkëkohor dhe institucioneve kulturore.

Doruntina Kastrati (1991) ka lindur në Prizren dhe jeton në Prizren dhe Prishtinë.

“I kept going to work sick, with an injured leg, and my leg was injured again in the same place because I kept my boots on all the time. We worked twelve to thirteen hours straight; we even worked twenty hour shifts. No rules at all.” So retells one of the laborers working in Kosovo’s construction industry. Doruntina Kastrati’s film presents workers who have been involved and harmed during big infrastructural-construction projects, and who reveal the human costs of the unregulated labor market. One of the primary consequences is a high rate of injury, which then precludes future work in the industry. Many workers state that they would rather face death than lose the ability to earn a living.

Kastrati’s film is the result of extensive research, including dozens of interviews, close readings of official documents, and digging in archives. The piece was inspired by her interest in construction and buildings, but instead of talking to engineers and planners, the artist started listening to the testimonies of workers who had lost their jobs or been humiliated or disabled while building Kosovo’s highways. The film shows those who go unseen: the invisible working class, the precariat with no guarantee or legal protection in quasi-feudal conditions of extreme exploitation. It tells stories of workers who died, lost their eyes or hands, and were left disabled for the rest of their lives while working for 70 euro cents per hour for two leading global companies, Bechtel and Enka—both also patrons of contemporary art and cultural institutions.

Doruntina Kastrati (1991) was born in Prizren and lives in Prizren and Prishtina.

IMAN ISSA

REPLICA FOR
ILLUSTRATION

2018



Replikë për Ilustrim është një seri prej trembëdhjetë fotografish të paraqitjeve pa emër të marra nga katalogu *Arti i njëzet e dy shekujve të kaluar*. Në veprën e saj, Iman Issa e bën tekstin të dukshëm, duke e përdorur atë si bashkëpunëtor me struktura të ndryshme skulpturore. Këtu është e kundërta: artistja është e interesuar për fotografinë si një formë ekspozimi nga një histori specifike, konteksti dhe rrëfimi i së cilës mbetet i paemëruar. Megjithatë, këto instalacione kanë histori për të treguar. Ato ndërtojnë marrëdhënie midis origjinës dhe destinacionit të tyre të fundit në vitrina. Ato gjithashtu jetojnë, plaken dhe vuajnë. Shumë prej artefakteve kanë humbur një pjesë të veprimit të tyre kur janë marrë nga habitat i tyre origjinal, duke krijuar një hendek mes objektit dhe muzeut si mjedisi i tij i ri. Artistja pyet: “A mund të ndodhë që objektet në muze dhe ato në botën e jashtme të jetojnë në vija paralele që kurrë nuk kryqëzohen, pavarësisht se sa të ngjashëm duken?” Kuratorët vazhdojnë: “Si ta zhvendosim mënyrën e ekspozitës, nga mburrja te njëri-tjetri se çka është nxjerrë deri te një kulturë më e ndërruar e shkëmbimit, bashkëjetesës dhe kuptimit?” Pavarësisht nga historia e tij e gjatë, ka ende shumë për të mësuar së çfarë është dhe çfarë mund të bëjë një medium i ekspozitës.

Iman Issa (1979) ka lindur në Kajro dhe jeton në Berlin.

Replica for Illustration is a series of thirteen photographs of unnamed displays taken from the catalogue *Art of the Past Twenty-Two Centuries*. In her work, Iman Issa makes text prominent, using it as a collaborator with different sculptural structures. Here it is the opposite: the artist is interested in the image as a form of display from a specific history, whose context and narrative remain unnamed. Yet these installations have stories to tell. They build relationships between their origin and their final destination in the vitrines. They also live, age, and suffer. Many of the artifacts have lost part of their agency when they were taken from their original habitat, creating a gap between the object and the museum as its new environment. The artist asks: “Could it be that objects in museums and those in the outside world live on parallel lines that never intersect, regardless of how similar they appear to be?” The curators follow: “How to shift the display mindset, from showing off to each other what was extracted to a more interdependent culture of exchange, coexistence, and meaning?” Despite its long history, there is still so much to learn about what a medium of exhibition is and can do.

Iman Issa (1979) was born in Cairo and lives in Berlin.



ARCHAEOLOGICAL
EXCAVATIONS
IN PROGRESS/
GËRMIMET
ARKEOLOGJIKE
NË PROGRES

2021

Gjatë dhjetë viteve të fundit, në Kosovë janë zhvilluar projekte madhore infrastrukture—autostrada dhe rrugë anësore, si rezultat i kërkimit për një të ardhme më të ndërlidhur. Në këto përpjekje, e kaluara shpesh del në pah përmes gërmimit të mbetjeve të shtigjeve antike. Këto zbulime përfaqësojnë një moment kritik në të cilin zhvillimet e ardhshme kërcënojnë thesaret e së kaluarës. Në disa raste, rruga e ndërtimit të autostradës mund të devijohet për të shpëtuar trashëgiminë arkeologjike, por në raste të tjera e kaluara fshihet në emër të zhvillimit. Gjatë projekteve të ndërtimit të autostradave në të gjithë Kosovën, janë gjetur dhe rrezikuar shumë vendbanime antike. Disa nga këto zona janë hulumtuar dhe dokumentuar, dhe shumë mbetje arkeologjike janë vendosur në Kalanë e Prizrenit.

Gjetjet arkeologjike që datojnë nga periudha neolitike janë ekspozuar në sallën kryesore të Muzeut të Kalasë së Prizrenit. Ekspozita thekson rëndësinë e së kaluarës së përbashkët, mësimet që duhen nxjerrë duke studiuar atë dhe rolin thelbësor që luan ky brez në ruajtjen e kësaj pasurie për brezat e ardhshëm. Salla e dytë e muzeut përdoret kryesisht si një punëtori për studentët e arkeologjisë të Universitetit të Prishtinës dhe tani është e hapur për publikun. Gjetjet arkeologjike të prezantuara këtu tregojnë përplasjen mes zhvillimit dhe mbrojtjes, pasi ato u gërmuan pranë ndërtimit të autostradës në pjesën qendrore të Kosovës. Këto mbetje janë të dokumentuara, klasifikuara dhe të renditura me kujdes. Një pjesë e këtyre janë vlerësuar si prova të rëndësishme të kulturës arkeologjike dhe do të ruhen dhe ekspozohen, ndërsa pjesët e tjera do të varrosen përsëri në tokë.

Këto përpjekje na drejtojnë në një sërë pyetjesh: Si e përkufizojmë trashëgiminë kulturore? Cilat janë kriteret bazë për të dalluar se çfarë duhet të ruhet dhe çfarë jo? Si mund të përcaktojmë kufirin ndërmjet ruajtjes dhe zhvillimit? Dhe si mund të kontribuojë arti bashkëkohor në gjithë këtë proces?

In the past ten years Kosovo has undertaken major infrastructural works—highways and bypasses—seeking a more connected future. In these efforts, the past is often encountered through the excavation of remains of ancient paths. These revelations represent a critical moment in which future developments threaten the treasures of the past. In some cases the highway construction route could be diverted to save archaeological heritage, but in other instances the past was erased in the name of development. During highway construction projects throughout Kosovo, such as the one on display, many ancient settlements have been found and subsequently endangered. Some of these sites have been researched and documented, and many archaeological remains have been placed in the Castle of Prizren.

Archaeological findings dating back to the Neolithic period are exhibited in the main hall of the Museum of the Castle of Prizren. The display highlights the importance of the common past, lessons to be learned by studying it, and the essential role this generation plays in safeguarding it for future generations. The second hall of the museum is used mainly as a workshop for students of archaeology at the University of Prishtina and is now open to the public. The archaeological findings presented show the clash between development and safeguarding, as they were excavated near the highway construction in central Kosovo. These remains are carefully documented, classified, and sorted. Part of these have been evaluated as important evidence of archaeological culture and will be conserved and exhibited, while other parts will be buried back into the ground.

These efforts lead to a set of questions: How do we define cultural heritage? What is the base criteria to distinguish what should be conserved and what not? How do we draw a line between conservation and development? And how can contemporary art mediate in this process?



(H)

HAMAMI I GAZI
MEHMET PASHËS/
GAZI MEHMED PASHA
HAMMAM

RRUGA SARAÇËT

VALBONA ZHERKA

Hamami i Gazi Mehmed Pashës është ndërtuar gjatë viteve 1573-1574 nga Gazi Mehmed Pasha (Sanjak-beu i Shkodrës), si pjesë e ansamblit arkitektonik që përfshinte gjithashtu Xhaminë Bajrakli, një shkollë e mesme (medrese), një shkollë fillore (mejtepe), një bibliotekë dhe një mauzole (tyrbe). Hamami karakterizohet nga një strukturë prej njëzet kupolash; dy kupola më të mëdha janë të mbuluara me tjegulla, ndërsa kupolat e tjera më të vogla dhe qemerët janë të mbuluara me plumb. Është e ndërtuar nga gurë dhe tulla të ndryshme dhe paraqet një shembull të hamamit dysh, për përdorim për të dy gjinitë.

Deri në vitin 1964, hamami ishte i rrethuar nga objekte tregtare, të cilat më pas u rrënuan, kur filluan ndërhyrjet konservuese në ndërtesë. Në vitet 1970, filluan iniciativat e fragmentuara për restaurim, të cilët nuk u përfunduan dhe objekti përfundimisht u braktis. Që nga viti 2000, pjesa e ftohtë e hamamit përdoret si hapësirë për aktivitete të ndryshme kulturore, artistike dhe arsimore.

Gazi Mehmed Pasha Hamam was built during between 1573 and 1574 by Gazi Mehmed Pasha (Sanjak-bey of Shkodra), as a part of the architectonic ensemble that also included the Bayrakli Mosque, a secondary school, a primary school, a library, and a mausoleum. The hamam is characterized by a structure of twenty domes; the two larger domes are covered with tiles, while the other smaller domes and vaults are covered with lead. It is constructed from various stones and has baths for both men and women.

Until 1964, the hamam was surrounded by commercial buildings, which were subsequently demolished when the hamam was restored for conservation purposes. In the 1970s, fragmented restoration efforts were initiated, but the site was ultimately abandoned. Since 2000, the unheated part of the hamam has been used as a gallery for various cultural, artistic, and educational activities.



VALBONA ZHERKA

MIGRATION/
SHTEGTIME

1999–2010

HOPE/
SHPRESA

2021

Valbona Zherka lindi në Prishtinë në vitin 1955. Ajo diplomoi në Akademinë e Arteve të bukura në vitin 1977 dhe më pas vazhdoi studimet në Beograd. Ajo punon me tapiceri dhe është frymëzuar nga kultura popullore, teknikat tradicionale, çështjet shoqërore, të drejtat e grave dhe e drejta e vetëvendosjes. Megjithatë, nuk ka qenë e lehtë për të si një artiste grua. Anipse puna e saj u ekspozua në vitet 1970 dhe 1980—në Sarajevë, Maribor, Beograd, Zagreb, Prishtinë dhe në ekspozitën “Gratë Krijuese të Jugosllavisë”, ku ishte e vetmja pjesëmarrëse nga Kosova—ajo ishte shpesh e marginalizuar dhe puna e saj u hoq nga kanuni i artit. Kur, në fillim të viteve 1990, ajo aplikoi për një punë si profesoreshë në Akademinë e Arteve të bukura, portofolio e saj, bashkë me një numër të veprave të saj, humbën përgjatë procesit.

Pikënisje për një retrospektivë të vogël të punimeve të saj në Autostrada Biennale janë dy vepra në formë tapicerie, të instaluara në Kompleksin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, *Qëndresa* dhe *Kullat e Qëndresës*, të dyja datuar nga viti 1978. Ato janë restauruar dhe një pjesë e munguar e tryptikës është krijuar veçmas për bienale, me titullin *Shpresa*. Artistja shprehet: “Jam e preokupuar me jetën në mes të së cilës jetoj, një e kaluar plot ngjarje që pret vetëm të shndërrohet në një vepër arti.” E nganjëherë veprat e artit duhet të presin—Zherka është shpesh e zënë si mësimdhënëse, menaxhere e projekteve të ndryshme, koordinatorë e terapisë profesionale, punonjëse sociale dhe redaktore.

“Përderisa rrugëtojmë, shpresojmë”, thotë ajo. Grumbulli i saj i endur në *Shtegtimi*, i rrugëve të mbivendosura dhe shtigjeve të migrimit ofroi një hartë orientimi për tërë Bienalen, me një metaforë të shpresës në një udhëtim i cili nuk përfundon kurrë, dy skajet e rrugëve që takohen në mes jetës diasporike dhe asaj lokale.

Valbona Zherka (1955) ka lindur dhe jeton në Prishtinë.

Valbona Zherka graduated from the Prishtina Academy of Fine Arts in 1977 and continued with her studies in Belgrade. She works with tapestry and is inspired by popular culture, traditional techniques, social issues, women’s rights, and the right to self-determination. Yet it has not been easy for her as a woman artist. Although her work was shown in the 1970s and 1980s—in Sarajevo, Maribor, Belgrade, Zagreb, Prishtina, and at the “Creative Women of Yugoslavia” exhibition, where she was the only woman from Kosovo—she was still often marginalized and her work omitted from the art canon. When, in the early 1990s, she applied for a professorship at the Academy of Fine Arts, her portfolio, along with a number of her tapestry works, were lost in the process.

The departure point for a small retrospective of her works at Autostrada Biennale are two tapestry pieces, installed at the Albanian League Museum: *Resistance* and *Resistance Towers*, both from 1978. They have been restored, and a missing part of the tryptic has been created for the occasion, entitled *Hope*, installed at the hammam. The artist states: “I am preoccupied with life in the midst of which I live, a past full of events that just waits to be turned into a work of art.” And sometimes artworks have to wait—Zherka is often busy as a teacher, project manager, coordinator of occupational therapy, social worker, and editor.

“As long as there is a journey, there is hope,” she states. Her woven cluster in *Migration* (installed at the hammam) of overlapping roads and migration paths offered an orientation map for the whole biennale, with a metaphor of hope in a journey, which is never completed, two ends of the roads meeting between diasporic and local life.

Valbona Zherka (1955) was born in Prishtina and lives in Prishtina.



(L C)

KINEMAJA LUMBARDHI/
LUMBARDHI CINEMA

RRUGA REMZI ADEMAJ 4

ROSSELLA BISCOTTI

Ndërmarrja shoqërore Kinemaja Bistrica/Lumbardhi u hap me 1 shkurt 1952, me një hapësirë prej 700 ulësesh. Kinemaja ishte kryesisht e famshme për shfaqjen e filmave antifashist dhe Western. Në më pak se një dekadë, ajo u bë një nga kinematë e vetme në Ballkan me sallë të mbyllur dhe të hapur. Së bashku me Kinemanë Punëtori (Kino Radnik), kinematë kishin një qarkullim mbi 500,000 bileta në vit. Në vitet 1990, me shfaqjen e video klubeve dhe video kasetave VHS, dhe rënien e bashkëpunimit politik në vend, kinemaja përjetoi një rënie të interesimit dhe ndërpreu aktivitetin e saj tre ditë para bombardimeve të marsit 1999. Pronësia e saj më vonë kaloi në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, duke e lënë kështu qytetin pa një kinema të vetme. Iniciativa dhe kërkesa nga komuniteti lokal për ringjalljen e Kino Lumbardhit u zhvillua gjatë edicionit të parë të festivalit të filmit dokumentar DokuFest në vitin 2002. Në vitin 2007 kryetari i Komunës së Prizrenit shpalli vendimin për prishjen e kinemasë në mënyrë që të ndërtohej një parking i ri. Si kundër-përgjigje, komuniteti kulturor i qytetit nisi iniciativën për mbrojtjen e Kinemasë Lumbardhi dhe pas një beteje të gjatë, Kinemaja Lumbardhi u hoq nga lista e privatizimit dhe u vendos në listën e trashëgimisë kulturore nën mbrojtje.

The social enterprise and cinema Bistrica/Lumbardhi Cinema opened on February 1, 1952, to a crowd of seven hundred citizens. It was popular for its screening of antifascist films and Westerns. In less than a decade, it became one of three cinemas in the Balkans with both indoor and outdoor screens. Together with the workers' cinema, Kino Radnik, the institution sold over 500,000 tickets annually. In the 1990s, with the emergence of video clubs and VHS, and the decline of political cooperation in the country, the cinema experienced a decrease in admissions and ceased its activity three days before the March bombings in 1999. Its ownership was later given over to the Privatization Agency of Kosovo, and Prizren ceased to have a single cinema. The demand from citizens for reviving Lumbardhi took place at the first edition of DokuFest film festival in 2002. In 2007 the mayor of Prizren announced the decision to demolish the cinema in order to build a new parking lot. In response, the initiative for the protection of Lumbardhi Cinema emerged, and after a long struggle Lumbardhi Cinema was taken off the privatization list and deemed a cultural heritage site.



LA CINEMATOGRAFIA E' L'ARMA PIU' FORTE

ROSSELLA BISCOTTI

LA CINEMATOGRAFIA
È L'ARMA PIÙ FORTE

2003-07

Në vitin 2004, Biscotti pikturoi frazën “La Cinematografia è l'arma più forte” (Kinematografia është arma më e fortë) me ngjyrë të zezë në muret e Fondazione Olivetti në Romë. Kjo ishte parulla e përdorur nga Benito Mussolini në vitin 1937, për hapjen e studios Cinecittà në Romë, e cila u ndërtua nga Ministria fashiste e Kulturës Popullore në mënyrë që të shfrytëzonte mediumin më të ri masiv si një mjet të fuqishëm propagandistik. Vetëm njëzet vjet para kësaj, Lenini deklaroi: “Nga të gjitha artet, për ne kinemaja është më e rëndësishmja.” Piktura në mur më vonë u shndërrua në një imazh që shfaqet në kinema para dhe pas shfaqjeve. Si një koment i fuqishëm mbi shoqërinë pas së vërtetës, veçanërisht në kontekstin e një Italie të sunduar nga manjati mediatik Silvio Berlusconi, ndërhyrja e Biscottit tregon për prodhimin e pajtimit nëpërmjet rrjedhës së vazhdueshme të imazheve në argëtimin e tanishëm. Ajo e vendos slloganin si një paralajmërim ironik në spektrin historik të makinerisë së propagandës në politikën botërore. Vepra e Biscottit është e drejtuar drejt zhvendosjes dhe rishkrimit të kujtesës kolektive. Artistja është e fascinuar nga hendeqet që ekzistojnë mes këputjeve historike dhe i bën ato të dukshme përmes skulpturës, zërit dhe filmit. Intervenimet e saj ndodhin në terrene të ndryshme historike dhe territore gjeografike, për të treguar ndërthurjen e fashizmit dhe kolonializmit në shërbim të kontrollit të shoqërisë nga kapitalizmi. Vetërefleksiviteti i veprës *La Cinematografia è l'arma più forte*'s na rikujton faktin se: si dhe ku artistët e pozicionojnë vetën në pikat kritike të kthesës dhe e ndryshojnë historinë.

Rossella Biscotti (1978) ka lindur në Molfetta dhe jeton në Bruksel.

In 2004, Rosella Biscotti painted the phrase “La Cinematografia è l'arma più forte” (cinematography is the strongest weapon) in black paint on the walls of Fondazione Olivetti in Rome. It was the slogan used by Benito Mussolini in 1937 to open the Cinecittà Studios in Rome, which was built by the fascist Ministry of Popular Culture in order to exploit the newest mass medium as a powerful propaganda tool. It was only twenty years earlier that Lenin declared: “Of all the arts, for us cinema is the most important.” The wall painting in Rome was later transformed into a projected still image shown in cinemas before and after screenings. As a powerful comment on post-truth society, especially in the context of an Italy ruled by media tycoon Silvio Berlusconi, Biscotti's intervention points to the manufacturing of consent through the flow of images in entertainment today. She places the slogan as an ironic warning in the historical spectrum of propaganda machinery in world politics. Biscotti's work is geared toward shifting and rewriting collective memory. The artist is fascinated by the gaps that exist between historical ruptures, which she makes visible through sculpture, sound, and film. Her interventions take place in different historical terrains and geographical territories to show the intertwining of fascism and colonialism in service of capitalism's control society. *La Cinematografia è l'arma più forte*'s self-reflexivity reminds us that how and where artists position themselves in critical turning points make and change history.

Rossella Biscotti (1978) was born in Molfetta and lives in Brussels.



(S E)

SHTËPIA E SHANI
EFENDIUT / SHANI
EFENDI HOUSE

RRUGA FARKATARËT

SEZGİN BOYNIK &
TEVFİK RADA

Shtëpia e Shani Efendiut u përdor si një shtëpi e komunitetit gjatë periudhës jugosllave për të akomoduar takime politike dhe shoqërore. Është pjesë e ansamblit të banimit së bashku me Selamllëkun (shtëpi për mysafirë). Kompleksi gjendet në rrugën Farkatarët pranë Kinemasë Lumbardhi, Teqes së Halvetive dhe shtëpive të tjera tradicionale. Ndërtesa është një shembull i një shtëpie me qoshk qendror (galeri) e rrethuar nga shtylla rrethore, e ndërtuar gjatë viteve 1930. Ka një bodrum të ngritur, një kat përdhes, një galeri qendrore dhe shkallë rrethore. Fillimisht është shfrytëzuar si shtëpi e banimit, kurse më vonë gjatë periudhave të ndryshme kohore është shfrytëzuar edhe si ndërtesë administrative.

Shani Efendi House was used as a community house during the Yugoslav period to accommodate political and social meetings. It is part of the residential ensemble together with the guest house. It is situated on Rruga Farkatarët (the blacksmiths' street), near the Lumbardhi Cinema, Halveti Tekke, and other traditional houses. The building is an example of a house with a central gallery surrounded by circular columns, built during the 1930s. It has a raised basement, a ground floor, a central gallery, and circular stairs. It was built as a residential house, but was later used as an administrative and community-oriented building.

SEZGİN BOYNIK &
TEVFİK RADA

WHO ARE FERİT AND
NAKIYE BAYRAM?/
KUSH JANË FERIT DHE
NAKIYE BAYRAM?

2021

Fotokopija originala "Zabelješka u čašt izlaska iz
štampe prvog broja časopisa "Socijalističke zora"
u Skoplju"

Ferit Bayram (1888-1965) ishte njëri nga intelektualët e majtë turq më me ndikim në Jugosllavi, i cili ishte i pari që redaktoi një alfabet në turqishten moderne në Jugosllavi, duke filluar në vitin 1947. Ferit Bayram ishte mësues, redaktor, shkrimtar, përkthyes dhe aktivist politik. Ai jetoi pothuajse tërë jetën e tij në Shkup, së bashku me Nakiye Bayram, e cila krahas Rosa Pavleva ishte njëra nga gratë e pakta në atë kohë që u përfshi në kauza socialiste në Maqedoni dhe Kosovë. Politizimi i Ferit Bayram filloi kur ai iu bashkua organizatës revolucionare Ittihat ve Terakki në 1908, e cila u përpoq ta rrëzonte pushtetin absolut monarkist të Sulltanit. Më pas, ai u përfshi në formimin e Partisë së parë Social Demokrate në Shkup, e cila ishte e lidhur me Partinë Socialiste Gjermane. Kjo çoi në politizim të mëtejshëm të Feritit: ai mori pjesë në organizimin e festimeve për Ditën e Majit në vitin 1909, përktheu *Manifestin Komunist* në turqisht, u anëtarësua në Federatën Ballkanike, dhe më e rëndësishmja, pati aktivitet anti-luftë gjatë Luftërave Ballkanike dhe Luftës së Parë Botërore. Pas Luftës së Parë Botërore, Ferit Bayram u bashkua me Partinë Komuniste Jugosllave të sapo themeluar dhe mori pjesë si delegat në kongresin themelor të dytë të partisë, më 1920 në Vukovar. Ai e redaktoi *Socijalistička Zora* dhe *Sosyalist Fecri*, si dhe avokoi së bashku me Zef Lush Markun dhe Haxhi Ymer Lutfi Paçarizin, mes popullatës myslimane në Kosovë dhe Maqedoni. Ai ishte aktiv pranë Komunës së Shkupit, dhe, si anëtar i Partisë Komuniste, ishte edhe anëtar i parlamentit demokratik jetëshkurtër të Mbretërisë së Jugosllavisë. Ky projekt kërkimor bazohet në materiale arkivore, përkthime të reja dhe intervista, dhe paraqet Ferit dhe Nakiye Bayram dhe bashkëmoshatarët e tyre në kontekstin e traditës socialiste ballkanike, të ndarë midis tri perandorive të mëdha (osmane, austro-hungareze dhe ruse) dhe kombeve të panumërta të vogla. Projekti tregon historinë e kauzave dhe jetës pasionante të aktivistëve që teorizonin në terren: duke zbuluar, nga e para, një model të ri të organizimit që do të ishte në të njëjtën kohë anti-imperialist, anti-nacionalist dhe anti-kapitalist.

Sezgin Boynik (1977) u lind në Prizren dhe jeton në Helsinki dhe Prizren.

Tevfik Rada (1991) u lind dhe jeton në Prizren.

Ferit Bayram (1888–1965) was one of the most influential Turkish leftist intellectuals in Yugoslavia, who, in 1947, was the first to employ the modern Turkish alphabet in Yugoslavia. Bayram was a teacher, editor, writer, translator, and political activist. He lived almost all his life in Skopje, together with Nakiye Bayram, who, alongside Rosa Plaveva, was one of few women at the time to be involved in socialist causes in Macedonia and Kosovo. His politicization started when in 1908 he joined the revolutionary organization Ittihat ve Terakki, which sought to overthrow the monarchist power of the Sultan. He then became involved in the formation of the first Social Democratic Party in Skopje, which was aligned with the German Socialist Party. This led to further politicization: the organization of a May Day celebration in 1909, the translation of *The Communist Manifesto* into Turkish, his joining the Balkan Federation, and, most importantly, his anti-war activities during the Balkan Wars and World War I. After the war, he joined the newly founded Yugoslav Communist Party and participated as a delegate at its foundational second congress in 1920. He edited the newspapers *Socijalistička Zora* and *Sosyalist Fecri*, as well as agitated, together with Zef Lush Marku and Haxhi Ymer Lutfi Paçarizi, among the Muslim population in Kosovo and Macedonia. He was active in the Skopje municipality and, with the Communist Party, was a member of the short-lived democratic parliament of the Kingdom of Yugoslavia. This research project is based on archival materials, new translations, and interviews, and presents Ferit and Nakiye Bayram and their peers in the context of the Balkan socialist tradition, torn between three great empires (Ottoman, Austro-Hungarian, and Russian), and countless small nations. It tells the story of the passionate causes and lives of activists theorizing in the field; figuring out, from scratch, a new model of organization that would be at the same time anti-imperialist, anti-nationalist, and anti-capitalist.

Sezgin Boynik (1977) was born in Prizren and lives in Helsinki and Prizren.

Tevfik Rada (1991) was born in Prizren and lives in Prizren.



(F W)

PUNËTORIA E
FILIGRANIT/
FILIGREE WORKSHOP

RRUGA REMZI ADEMAJ 27

CAMILA ROCHA

Punëtorja e Filigranit është një punëtori dhe dyqan ku praktikohet zanati tradicional i krijimtarisë së stolive komplekse. Prizreni falë pozitës së volitshme, e vendosur në kryqëzim të rrugëve tregtare gjatë periudhës Osmane, ndër shekuj ka qenë një qendër e rëndësishme tregtare dhe artizanale. Filigrani, arti i lakimit dhe përdredhjes së fijeve prej argjendi ose ari në modele dhe stoli dekorative, është një nga traditat më të nderuara të Prizrenit. Punëtorja është një vend strehim i qetë nga rruga e zhurmshme. Këtu, mjeshtrat prodhojnë vepra arti dhe stoli të punuara me dorë. Zejtarët gjatë periudhës së ish-Jugosllavisë, kanë qenë të punësuar në fabrikën Filigran, e cila u privatizua në vitin 2000. Qëllimi kryesor i tyre është sigurimi i vazhdimësisë së kësaj zeje unike në Prizren. Vizitorët mund të vëzhgojnë prodhimin e stolive dhe të marrin pjesë në bisedat e përditshme ndërmjet zejtarëve dhe komunitetit të tyre.

Filigree Workshop is a workshop and store where the traditional craft of intricate jewelry making is practiced. Prizren has been a craft center for centuries, as it was situated at the junction of Ottoman trade routes spanning east-west and north-south. Filigree, the art of bending and twisting threads of silver or gold into ornamental designs, is one of Prizren's most time-honored traditions. The workshop is a quiet retreat from the busy street. Here, masters produce handmade artwork and jewelry. The craftspeople were formerly employed at the Yugoslav filigree factory, which was privatized in 2000. Their main goal is to ensure the continuation of this unique craft in Prizren. Visitors can observe the production of the jewelry and take part in the everyday conversations between the craftspeople and their community.



(B B)

URA E KALTËR/
BLUE BRIDGE

RRUGA REMZI ADEMAJ

CAMILA ROCHA

Ura e Kaltër gjendet në perëndim të Urës së Gurit. Sipas të dhënave historike, ura u ndërtua fillimisht nga druri dhe shpesh shkatërrohej për shkak të zjarreve aksidentale ose përmytjes së lumit. Banorët e quanin Ura e Mallkuar. Në vitin 1980 u ndërtua një strukturë e re prej betoni, me gardh metalik. Në vitin 2012, artistët lokalë propozuan të vendosin kyçe metalike në gardhin e urës me qëllim që të thyejnë mallkimin dhe ta kthenin Urën e Mallkuar në Urën e Dashurisë. Që nga atëherë, ura është mbuluar me kyçe nga banorët dhe vizitorët, duke u shndërruar në një pikë atraktive për vizitorët.

The Blue Bridge is located next to the Stone Bridge. According to historical records, the bridge was initially constructed out of timber and was often destroyed due to accidental fires or river flooding. It has been also called the Cursed Bridge by residents. In the 1980 a new concrete structure was constructed, with blue metal fences. In 2012, local artists proposed to place metal locks on its fence in order to break the spell and turn the Cursed Bridge into the Love Bridge. Since then, the bridge has been covered in locks by residents and visitors alike and might soon become too heavy to stand safely.



CAMILA ROCHA

A ROSE
IS A ROSE
IS A ROSE?/
NJË TRËNDAFIL,
ËSHTË NJË TRËNDAFIL
ËSHTË NJË TRËNDAFIL?

2021

IN COLLABORATION WITH
FILIGREE MASTERS

Filigrani i artë dhe i argjendit është praktikuar në Prizren qysh prej shekullit të XV-të. Në vitet e 40-ta, Prizreni ishte qendra e ndërmarrjes shtetërore jugollave të filigranit, e cila ishte aktive deri në vitin 1999. Sot, dhjetë mjeshtër e vazhdojnë zëjen e tyre, duke prodhuar zbukurime elegante, qytetare e fetare. Para shpikjes së fotografisë, ilustrimi botanik i krijuar në akualet ishte mënyra e vetme e regjistrimit vizual të shumë llojeve të bimëve në botë. Akualet është një metodë e veçantë, sepse çdo shtresë e ujit dhe ngjyrës së ngadalë e sjellë imazhin më pranë “realitetit”—e pamundur të arrihet në ndonjë mënyrë tjetër. *Një trëndafil, është një trëndafil është një trëndafil?* është përkthim i një bisede në mes mjeshtërve të filigranit në Prizren dhe artistes Camila Rocha në São Paulo, Brazil. Rocha njihet për projektin e saj afatgjatë Florikultur, i cili vëzhgon dhe angazhohet me modele të ndryshme të bisedave të përditshme të bazuara në lule dhe bimë, nga Stambolli e deri në São Paulo. Artistja krijon ndërhyrje dhe mjedise që vënë në dyshim dhe imagjinojnë mënyra të tjera të bashkëjetesës. Çdo ilustrim me akualet është një proces ndërlidhës i kujdesit, vëzhgimit afatgjatë dhe bisedës së heshtur. Për *Një trëndafil, është një trëndafil është një trëndafil?*, Rocha ndan me publikun portretet e saja delikate të bëra nga lulet, me mjeshtër e filigranit, duke bashkëkrijuar kështu linjën e saj të parë të bizhuterive. Të dy skajet e bisedës përcaktohen nga puna e imët, e durueshme dhe e kujdesshme. Përderisa Rocha u dërgoi mjeshtërve videot e saj të vizatimit, ajo poashtu shikoi videot e tyre—se si ata krijojnë ngadalë dhe me zell objekte të reja. Prandaj, kështu gjenerohet një kanal i ri i florikulturës nga Ballkani në Brazil dhe anasjelltas, një gjuhë e re hibride. Punës me dashuri i përgjigjet me një tjetër punë me dashuri, një përgjigje e cila do të marrë formën e një skulpture publike në brigjet e Lumbardhit.

Camila Rocha (1977) u lind në São Paulo dhe jeton në São Paulo dhe Stamboll.

Silver and gold filigree has been practiced in Prizren as far back as the fifteenth century. In the 1940s, Prizren was home to the Yugoslav state filigree company, which was active until 1999. Today, ten masters continue their craft, producing exquisite civil and religious adornments. Prior to the invention of photography, botanical illustration, done in watercolor, was the only way of visually recording the world's many plant species. Watercolor is a distinct method because each layer of water and color brings the image closer to “reality”—impossible to achieve any other way. *A Rose Is a Rose Is a Rose?* is a translation of a conversation between filigree masters in Prizren and the artist Camila Rocha. Rocha is known for her long-term project Florikultur, which observes and engages with different models of floral—and plant—based conversations in the everyday, from Istanbul to São Paulo. She creates interventions and environments that question and imagine other ways of cohabitating today. Every watercolor illustration is a process of care, long-term observation, and silent conversation. For *A Rose Is a Rose Is a Rose?* Rocha shares her delicate floral portraits with the filigree masters, cocreating her first jewelry line. Both ends of the conversation are defined by minute, patient, careful work. While Rocha sent them her drawing videos, she also watched their videos—how they slowly and diligently create new objects. Therefore, a new channel of Florikultur from the Balkans to Brazil and back, a new hybrid language, is generated. Labor of love is responded back with labor of love, a response which will also take the form of a public sculpture on the banks of Lumbardhi.

Camila Rocha (1977) was born in São Paulo and lives in São Paulo and Istanbul.



(G S)

STACIONI I
KARBURANTIT/
GAS STATION

RRUGA SUZI ÇELEBIA

ULF AMINDE &
MANUEL GOGOS

Është një stacion karburanti i zakonshëm si shumë të tjera. Sidoqoftë, është i vendosur në mënyrë piktoreske në qytetin e vjetër të Prizrenit, në afërsi të ndërtesës së Komunës. U hap në mes të viteve 1970, kur shumë punëtorë po largoheshin nga Jugosllavia për të punuar në Evropën Perëndimore. Për punën e Ulf Aminde dhe Manuel Gogos, stacioni i karburantit bëhet një pikë e materializuar e nisjes dhe mbërritjes së diasporës, një vend në hartë që shënon qartësinë dhe infrastrukturën e migrimit, udhëtimit dhe destinacionit.

It is a gas station like many others. It is, however, picturesquely located in the old town of Prizren, in front of the municipality building. It was opened in the mid-1970s, when many guest workers were leaving Yugoslavia to labor in Western Europe. For Ulf Aminde and Manuel Gogos's work, the gas station becomes a materialized point of departure and arrival of the diaspora, a place on the map marking the tangibility and infrastructure of migration, travel, and destination.



ULF AMINDE &
MANUEL GOGOS

STREET OF LABOUR:
MIGRATION MONUMENT
(KOSOVO CHAPTER) /
RRUGA E PUNËS:
MONUMENTI I MIGRIMIT
(KAPITULLI KOSOVA)

2020-21

Njerëzit në Gjermani janë shumë krenarë për rrugët dhe autostradat e tyre, por kush i ndërtoi ato? Për t’iu përgjigjur kësaj pyetjeje gjoja të lehtë, artisti Ulf Aminde dhe autori Manuel Gogos diskutuan me kompani dhe dëshmitarë, kërkuan arkiva e dosje: Kush ishte përfshirë në ndërtimin e rrugëve gjermane që nga Lufta e Dytë Botërore? Dhe prej nga erdhën? Shumë nga ata ishin “punëtorë mysafirë” nga Italia, Turqia ose ish-Jugosllavia. Rrugët janë arkiva të historisë së punës dhe migrimit në Evropë. Çdo rrugë bashkohet me tjetrën, duke formuar një sërë arteriesh të nisjeve, zhvendosjeve, shpresave, mbërritjeve. Së bashku, rrugët formojnë një hapësirë për një kolazh shoqëror, një mënyrë e përkohshme e aktive për të kujtuar dhe jetuar në një shoqëri migrimi. Në Prizren, filmi dhe një poster—*Rruga e Punës. Monumenti i Migrimit*—shfaqen në një stacion benzine—njëra nga ato vende, në skajin tjetër të rrugës, nga ku disa punëtorë të huaj janë nisur dhe nisen për të kërkuar punë në Veri, ku edhe më pas kthehen.

Ulf Aminde (1969) u lind në Stuttgart dhe jeton në Berlin.

Manuel Gogos (1970) u lind në Gummersbach dhe jeton në Bonn.

People in Germany are very proud of their roads and highways, but who actually built them? In order to answer this supposedly simple question, the artist Ulf Aminde and the author Manuel Gogos consulted companies and witnesses, searched archives and files: Who was involved in the construction of German roads since World War II? And where did they come from? Many of them were “guest workers” from Italy, Turkey, or former Yugoslavia. The streets are archives of the history of work and migration in Europe. Every road merges with another one, forming a set of arteries of departures, displacement, hopes, arrivals. Together the roads form a canvas for a social collage, a temporary and active way of remembering and living in a migration society. In Prizren, the film and poster *Street of Labour: Migration Monument* is presented at a gas station—one of those places, at the other end of the road, from where some guest workers departed (and still depart) to look for jobs in the north, and where they return to.

Ulf Aminde (1969) was born in Stuttgart and lives in Berlin.

Manuel Gogos (1970) was born in Gummersbach and lives in Bonn.



(H R)

SHTËPIA PRANË
LUMIT/ HOUSE AT
THE RIVER

RRUGA REMZI ADEMAJ 27

MAŁGORZATA
MIRGA-TAS IN
COLLABORATION WITH
EDIS GALUSHI

Ndërtesa ku funksionon Universiteti Anadolu ka një pozitë dominuese, pranë shtratit të lumit Lumbardh. Pozita e saj dominuese ka krijuar një hapësirë ideale për prezantimin e veprës së artistes Małgorzata Mirga-Tas. Ndërtesa e cila ka një sipërfaqe masive të fasadës, me shumë pak dritare, tashmë është shndërruar në një platformë arsimore.

The building hosting Anadolu University is very visible from the riverbank. It seemed like a perfect canvas for Małgorzata Mirga-Tas's work, as it has large facade surfaces, very few windows, and is already an educational platform.



MAŁGORZATA
MIRGA-TAS

HERSTORIES

2019-21

Shpresa Agushi
Gjilan/ Gnjilane
Avokuese e të Drejtave të Grave/
Women's Rights Advocate

Arleta Avdosoj
Prizren
Motër Medicinale/ Nurse

Nicoleta Bitu
Bucharest
Aktiviste e Komunitetit/
Community Activist

Zinet Galushi
Prizren
Amvise/ Homemaker

Delaine Le Bas
London
Artiste/ Artist

Esma Redžepova
Shkup/ Skopje
Këngëtare & Humaniste/
Singer & Humanitarian

IN COLLABORATION
WITH EDIS GALUSHI

Małgorzata Mirga-Tas është një artiste vizuale rome nga Polonia e cila bashkë me anëtarët e komunitetit rom nga Prizreni, e kanë veshur një shtëpi pranë lumit Lumbardh, duke e mbuluar atë me një seri të portreteve të grave të jashtëzakonshme rome, vendase dhe ndërkombëtare. Viteve të fundit, Mirga-Tas ka përpiluar një arkivë emocionale të historive rome. Kolazhet e Mirga-Tas janë krijuar nga fragmente të pëlhurave të ndryshme, “duke e hedhur materialin brenda pikturës.” Shumica e pëlhurave janë marrë direkt nga garderoba e grave të portretizuara, dhe përbëhen nga pjesë të fundeve, shamive apo këmbishave të qëndisura mbi perde, roba të shtratit dhe lecka. Materiali i përdorur përmban në vete histori, gjurmë jete, gjurmë të përdorimit dhe të energjisë. Perdet shndërrohen në arkitekturën themelore të veprave dhe në të njëjtën kohë, në bazën pamore për krijimin e tregimeve dhe narracionit feminist. “Bazuar në përvojën shumëvjeçare të punës me komunitetet rome në vendbanimet rome, e kam vërejtur se gratë rome gradualisht po e emancipojnë veten prej strukturës patriarkale. Gjithnjë e më shumë gra rome janë aktive, ato punojnë për ndryshim, luftojnë për edukimin e fëmijëve të tyre, ato duan që zëri i tyre të dëgjohet në mjediset rome të cilat zakonisht janë shumë tradicionale.” Punët e Mirga-Tasit prezantojnë disa pyetje të rëndësishme për kohën tonë: Si lidhen marrëdhëniet e pushtetit me përfaqësimin? Cili është pozicioni i artit tradicional brenda kanunit të artit bashkëkohor? Si duket feminizmi i minoriteteve në një komunitet tradicional? A mund të ketë një kulturë të akulturacionit (asimilimi i një kulture te një tjetër e cila është më e fortë, më dominante) dhe, nëse po, si mund të mësojë shumica nga pakica? Së fundmi, të punosh me identitetin, sidomos atë që i ka rrënjët në padrejtësi, a nënkupton një strategji pohuese dhe emancipuese apo një të tillë që izolon dhe zvogëlon?

Małgorzata Mirga-Tas (1978) u lind në Zakopane dhe jeton në Czarna Góra.

Edis Galushi (1989) u lind dhe jeton në Prizren.

Małgorzata Mirga-Tas is a Romani visual artist from Poland who, together with Romani activist Edis Galushi and members of the Prizren Romani community, covered a house with a series of portraits of extraordinary Romani women, both local and international. Mirga-Tas has been compiling an affective archive of Romani herstories. Mirga-Tas's collages are created from fragments of different fabrics by “throwing the material into the painting.” Many of the fabrics are taken directly from the wardrobes of the women depicted, and consist of bits of skirts, scarves, or shirts sewn onto curtains, drapes, bedclothes, or rags. The material employed literally carries history, traces of life and use, and energy. The curtains become the underlying architecture of the works and, at the same time, the visual basis for the creation of feminist narratives. “Based on many years of experience working with the Roma communities in Roma settlements, I have noticed that Roma women are gradually emancipating themselves from the patriarchal structures. More and more Roma women are active, they strive for change, they fight for education for their children, they want to have their voice heard in the usually very traditional Roma environment.” Mirga-Tas's works present many crucial questions for our times: How do power relations relate to representation? What is the place of traditional art within the canon of contemporary art? What does minority feminism in a traditional community look like? Can there be a reciprocal acculturation, and, if so, how can the majority learn from the minority? Finally, can working on identity, especially one rooted in the experience of injustice, be an affirmative and emancipatory strategy rather than a reductionist, isolating one?

Małgorzata Mirga-Tas (1978) was born in Zakopane and lives in Czarna Góra.

Edis Galushi (1989) was born in Prizren and lives in Prizren.



(T M)

MULLIRI TABAKHANE/
TABAKHANE MILL

RRUGA TABAKEVE 2

MARWA ARSANIOS

Mulliri Tabakhane gjendet në kompleksin Tabakhane (zonë ku kanë vepruar zejtarët për përpunimin e lëkurës) dhe është mulliri i fundit aktiv në Prizren. Më herët i quajtur Mulliri i Shasivar Beut, ka një plan drejtkëndor, ku uji nga lumi Lumbardh depërton në ndërtesë, duke aktivizuar tri gurë për bluarje, që shërbejnë për bluarjen e grurit dhe misrit. Kanali i ujit që fillon nga ura e Arastës dhe vazhdon në drejtim paralel me rrjedhën e lumit, depërton në ndërtesë dhe vazhdon të derdhet në lumë. Gjatë pjesës së parë të shekullit njëzet, kanali i ujit, i quajtur Kanali i Suziut, nga këtu ka vazhduar rrjedhën në perëndim të qytetit, deri në fshatin Grazhdanik. Mulliri dhe punëtorja e përpunimit të lëkurës janë ndërtesat e fundit që kanë mbetur nga kompleksi Tabakhane, që u shkatërrua kryesisht nga zhvillimet e hovshme urbane.

The Tabakhane Mill is situated in the Tabakhane compound (a leather-processing workshop), and is the last functioning mill in Prizren. Formerly called Shasivar Begs Mill, it has a rectangular plan, where water from the Lumbardhi activates three grinding stones, which grind wheat and corn. The water channel that starts from Arasta Bridge penetrates the building and continues to pour into the river at the Stone Bridge. In the first half of the twentieth century, the water channel, called Suzi Channel, continued to the west of the city, up to the village of Grazhdanik. The mill and the workshop for leather processing are the last remaining buildings of the Tabakhane compound, which was mostly destroyed by urban development.



MARWA ARSANIOS

WHO'S AFRAID
OF IDEOLOGY?/
KUSH KA FRIKË
NGA IDEOLOGJIA?

2018-20

Të vepruarit në përpjekje për ta rikonstruktuar jetën kundër makinerive të shfrytëzimit kapitalist është në themel të luftës anti-koloniale për ndryshime më të gjera shoqërore dhe politike sot, dhe gratë po luftojnë në kufij të ndryshëm të kësaj përpjekjeje. Tre filmat e serisë *Kush ka frikë nga ideologjia?* të Marwa Arsanios, endin një rrugë kryqëzore përmes përpjekjeve të grave—në vende të tilla si Siria Veriore dhe Kolumbia—për të kërkuar të drejtën për tokë dhe për t'u rilidhur me natyrën në një mënyrë të pandërmjetësuar. Vetëmbrojtja, eko-feminizmi, pronësia, shërimi, kontrolli i shtetit, autonomia, kolektiviteti, lufta autoktone, mbrojtja e farës dhe e drejta mbi tokë. Pyetjet relevante në kohë nga Arsanios shqyrtojnë jo vetëm mënyrat në të cilat ideologjia dhe teoria përkojnë me praktikën e jetës por edhe nëse “ne” mund të mishërojmë përgjigjet si ato jashtë këtyre qarqeve të luftës. *Kush ka frikë nga ideologjia?* pjesa e parë—përbëhet nga intervistat që artistja i ka realizuar me anëtarët e Lëvizjes Autonome të Grave Kurde, në Kurdistanin e Irakut, në lidhje me mundësitë e një praktike politike bazuar në jetë dhe natyrë. Pjesa e dytë drejtohet rreth vetë praktikës së komunës Jinwar, komunë vetëm e grave, në Sirinë Veriore, dhe kufizimeve imagjinare dhe kontekstuale që e formësojnë atë. Arsanios organizoi dy takime me gra fermere dhe feministe ekologjike nga Siria, Libani, Kolumbia, Meksika, India, Polonia, Danimarka dhe Greqia—në Varshavë dhe Sharjah—për të shkëmbyer njohuri rreth kooperativave dhe komunave. Pjesa e tretë nxjerr material nga këto shkëmbime intensive, duke u përqëndruar në luftën e vazhdueshme sistematike të zhvilluar kundër elementit më të vogël dhe më thelbësor të jetës—farës—dhe metodologjive të mbijetesës. Përderisa autonomia e farës është një kërcënim për korporatat transnacionale, qeveritë dhe paraushtarakët, për njerëzit autoktonë, farat janë simboli i rezistencës pas humbjes së gjuhës së tyre.

Marwa Arsanios (1978) u lind në Bejrut dhe jeton në Berlin.

Acting in an effort to realign life against the machineries of capitalist exploitation is at the core of the anti-colonial struggle for wider social and political change today, and women are fighting on its different frontiers. The three films of Marwa Arsanios's *Who's Afraid of Ideology?* series weave an intersectional path through the struggles of women—in places such as Northern Syria and Colombia—to claim the right to land and to reconnect with nature in an unmediated way. Self-defense, ecofeminism, ownership, healing, state control, autonomy, collectivity, indigenous struggle, seed protection, and land rights: these are the themes of Arsanios's work. Her timely questions probe not only the ways in which ideology and theory coincide with living practice, but also if “we” can embody the answers as those outside these circles of struggle. *Who's Afraid of Ideology? Part 1* is shaped around interviews the artist conducted with members of Kurdish Autonomous Women's Movement in Iraqi Kurdistan about the possibilities of a political praxis based on life and nature. Part 2 moves toward the actual practice of the women-only Jinwar commune in Northern Syria and the imaginary and contextual limitations that shape it. Arsanios convened two meetings with women farmers and ecological feminists from Syria, Lebanon, Colombia, Mexico, India, Poland, Denmark, and Greece—in Warsaw and Sharjah—to exchange knowledge around their cooperatives and communes. Part 3 draws from these intense exchanges, focusing on the ongoing systemic war waged against the smallest and the most essential element of life—the seed—and the methodologies of survival. While seed autonomy is a threat for transnational corporations, governments, and paramilitaries, for indigenous people seeds are the symbol of resistance after losing language.

Marwa Arsanios (1978) was born in Beirut and lives in Berlin.



(B S)

STACIONI I
AUTOBUSËVE/
BUS STATION

RRUGA DE RADA

EDONA KRYEZIU

VAHIDA RAMUJKIĆ

NÚRIA GÜELL &
LUMNIJE GËRGURI
STOJKAJ

Themelet e stacionit të autobusëve u vunë në 1978 dhe në vitin 1981 ky stacion u hap për publikun. Stacioni i autobusëve gjithashtu kishte një sallë ku mbaheshin dasma dhe ngjarje. Gjatë periudhës post-jugosllave, stacioni i autobusëve u përjashtua nga privatizimi dhe deri më sot vazhdon të përdoret si një objekt publik. Drejtori i tij refuzon përdorimin e tij tregtar dhe në vend të kësaj mirëpret instalimet e veprave të artit. Stacioni i autobusëve ka mirëpritur vepra arti në dy edicionet e mëparshme të Autostrada Biennale.

The foundations of the current bus station were laid in 1978, and in 1981 it opened to the public. The bus station also used to have a hall where weddings and events were held. During the post-Yugoslav period, the bus station was excluded from privatization and to this day remains in use as a public facility. Its director refuses its commercial use and welcomes art installations instead. The bus station has hosted artworks in the two previous editions of the Autostrada Biennale.



EDONA KRYEZIU

GREETINGS FROM
AN ELSEWHERE

2019-21

Përshëndetjet nga diku tjetër është një film i përbërë nga xhirime të ndryshme të marra nga kasetat e famshme private VHS. Në vitet e 90-ta, kasetat VHS përdorshin si një kanal komunikimi mes familjeve dhe miqve të ndarë gjatë dhe pas luftës në Kosovë. Kasetat dërgoheshin nga ata që jetonin në Kosovë për në diasporë dhe anasjelltas, duke shfaqur rrethana të reja të jetesës, qytete të reja, vendbanime të reja të azilit—më shkurt, edhe përshëndetjet nga diku tjetër, nga një vend tjetër. Këto kaseta udhëtuan përmes rrugëve jokonvencionale përtej kufijve, kontinenteve dhe shteteve, dërguar shpesh me aeroplan apo me autobusa, duke kaluar nëpër shumë duar. Kur mbërrinin në shtëpi, kudo që kjo ‘shtëpi’ ishte, familjet dhe fqinjët bashkoheshin, duke pritur me padurim imazhet nga larg.

Përmes një thirrje të hapur, Edona Kryeziu huazoi kasetat e qytetarëve, të cilat ajo i digjitalizoi dhe editoi në një arkivë kolektive filmike. *Përshëndetjet nga diku tjetër* filloi në vitin 2019 kur Kryeziu rastësisht i gjeti kasetat e vjetra VHS të familjes së saj dhe e krijoi një film prej tyre, i cili më pas u shfaq në Galerinë Kombëtare të Kosovës dhe në Galerinë Kombëtare të Arteve në Shqipëri. Duke i ndarë kasetat e saj personale me publikun, artistja zbuloi se janë ngjarje rituale dhe të përsëritura—ardhjet, shkuarjet, ditëlindjet, dasmat, diplomimet—ato që jo vetëm përshkruajnë por gjithashtu edhe e kanë formësuar mënyrën se si kosovarët jetuan me dhe përmes një dekade plot pasiguri. Marrë për bazë dokumentimin e pamjaftueshëm dhe të paktë të historisë së fundit kosovare, *Përshëndetjet nga diku tjetër* e kthen arkivën personale në një dëshmi të rëndësishme të së kaluarës që flet dhe e formëson të tashmen.

Edona Kryeziu (1994) ka lindur në Saarlouis dhe jeton në Prishtinë dhe Berlin.

Muzika:
Liburn Jupolli

Greetings from an Elsewhere is a found-footage film composed from numerous private VHS tapes. In the 1990s, VHS tapes were used as a communication channel between divided families and friends during and after the war in Kosovo. Cassettes were sent back and forth between the diaspora and those in Kosovo, displaying new living circumstances, new cities, new asylum residencies—greetings from an elsewhere. They traveled via unconventional routes across borders, continents, and countries, sent by way of airplane or buses, passing through many hands. Once they arrived home, wherever “home” was, families and neighbors gathered, curiously awaiting the images from afar.

Through an open call, Edona Kryeziu borrowed people’s VHS tapes, which she digitized and edited into a collective filmic archive. *Greetings from an Elsewhere* started in 2019 when Kryeziu stumbled across her family’s old VHS tapes and compiled a film out of them, which was then exhibited at the National Gallery of Kosovo and the National Gallery of Arts in Tirana, Albania. Sharing her private video cassettes with the public, the artist realized that it is ritualized and repetitive events—arrivals, departures, birthdays, weddings, graduations—have not only depicted but also shaped how Kosovars lived with and through a decade of uncertainty. In the shadow of scant documentation of recent Kosovar history, *Greetings from an Elsewhere* turns the personal archive into important testimony of the past that speaks and shapes the present.

Edona Kryeziu (1994) was born in Saarlouis and lives in Prishtina and Berlin.

Music:
Liburn Jupolli



VAHIDA RAMUJKIĆ

DISPUTED HISTORIES/
HISTORI TË
DISKUTUESHME

2006-ONGOING

Me ndarjen e Jugosllavisë, luftërat që ndodhën në vitet 90-të dhe me formimin e shteteve të reja, historia kolektive është shprishur. Verzione të ndryshme të librave shkollorë të historisë filluan të përhapeshin në të njëjtën zonë gjeografike, dikur të bashkuar nën socializëm. Rishikimet e vazhdueshme të kurrikulave historike na dëshmojnë se si narrativat historike janë mjete të fuqishme në projektimin e identiteteve kolektive kombëtare dhe mbajtjen e pozicioneve të fuqishme në rendin e ri liberalo-kapitalist. Këto histori revizioniste, tani të hartuara nga perspektiva kombëtare (serbe, boshnjake, kroate, sllovene, maqedonase, malazeze dhe kosovare-shqiptare), jo vetëm që ndryshojnë nga versioni i mëparshëm jugosllav, por edhe nga njëra-tjetra, në njëfarë forme duke e zgjatur situatën e konfliktit ose nxitjen e konflikteve të reja. Instalacioni artistik e hap një hapësirë mendimi për një pozicion (apo disa pozicione) të ri nga ku mund të tregohen narrativa të tjera, përtej perspektivave kombëtare dhe identitare.

Histori të diskutueshme është një bibliotekë në rritje e sipër e librave shkollorë të historisë nga territoret e ish-Jugosllavisë. Ajo paraqet rrëfime historike më pak të njohura nga të gjitha shtetet fqinje. Ramujkić e inicioi bibliotekën në vitin 2006 dhe sot kjo bibliotekë përmban mbi 300 libra të ndryshëm shkollorë të historisë. Instalacioni shpesh shoqërohet nga disa punëtori ku krahasohen libra të ndryshëm në bibliotekë dhe, përmes punës bashkëpunuese dhe transnacionale, shkohet drejt prodhimit të revistave (në formë të zines). Në këto punëtori, të gjithë konsiderohen ekspertë për tema e çështje historike dhe më pas ftohen të ndërtojnë rrëfime të reja, të përbashkëta, jo të dhunshme.

Vahida Ramujkić (1973) ka lindur dhe jeton në Beograd.

With the breaking up of Yugoslavia, the wars of the 1990s, and the formation of new states, collective history has fallen apart. Different versions of history textbooks started proliferating in the same geographical area once united under socialism. The ongoing revisions of historic curricula show us how historical narratives are powerful tools in engineering collective (national) identities and maintaining power positions in the new liberal-capitalist order. These revisionist histories, now designed from national perspectives (Serbian, Bosnian, Croatian, Slovenian, Macedonian, Montenegrin, and Kosovar-Albanian), are not only different from the previous Yugoslav version, but also from each other, in some sense prolonging the situation of conflict or inciting new ones. The installation opens a space for thinking about new positions from which other narratives beyond national and identitarian perspectives could be told.

Disputed Histories is a growing library of history textbooks from the former Yugoslavian territories. It presents lesser-known historical narratives from across neighboring states. Ramujkić initiated the library in 2006, and today it includes over three hundred different history textbooks. The installation is often accompanied by workshops where different textbooks in the library are compared and, through collaborative, transnational work, lead to the production of zines. In the workshops, everyone is considered an expert on historical matters and is invited to build new, common, nonviolent narratives.

Vahida Ramujkić (1973) was born in Belgrade and lives in Belgrade.



NÚRIA GÜELL &
LUMNIJE GËRGURI
STOJKAJ

VACATIONS WITH LUME/
PUSHIMET ME LUMEN

2013-21

Në vitin 2013, Núria Güell organizoi lojën “fshehtas” në portin e Gothenburgut, Suedi, me një azilkërkuese nga Kosova, një ish-police me emrin Maria. Maria ishte në proces të aplikimit, për herë të tretë, për leje-qëndrim në Suedi. Një kontratë u lëshua nga Bienalja e Gothenburgut në suedisht dhe në shqip—gjuha amtare e Marisë dhe Edi Mukës (drejtori artistik i bienales). Kontrata e punës me organizatën e artit u bë në konsultim me aktivistët dhe ishte e dobishme nga ana strukturore në sigurimin e leje-qëndrimit për Marinë. Në lojën “fshehtas”, të vënë në skenë gjatë ekspozitës, Maria ishte gjithmonë ajo që fshehej, ndërsa vizitorët ishin gjithmonë ata që kërkonin. Ftesa për të luajtur pothuajse gjithnjë përfundonte me një dialog të thellë rreth politikës së migrimit, azilit politik, integritetit dhe zhvendosjes, duke e kthyer lojën në bisedë. Projekti, i organizuar në kuadër të Bienales së 7-të të Gothenburgut dhe i kuruar nga Joanna Warsza, tani do të vizitohet sërish, por në anën tjetër të rrugës, në vendin nga vjen Maria—emri i vërtetë i së cilës është Lumnije Gërguri Stojkaj. Güell dhe Gërguri Stojkaj do të kalojnë një pushim të shkurtër në Prizren, duke ecur, duke vizituar dhe duke biseduar. Lindin pyetjet: Si është tani marrëdhënia mes artistes dhe bashkëpunëtores së saj? Si të shohim dhe të punojmë me marrëdhënie të pabarabarta në projekte bashkëpunuese, veçanërisht rreth çështjeve të migrimit? Cilat janë mënyrat etike të adresimit të asimetrive në art? Si e sheh Gërguri Stojkaj artin si pjesë të rrugëtimit të saj në Suedi, ku tani punon si roje burgu? Në pushimin e tyre, të dyja do të flasin për vendlindjen, mërgimin, përkatësinë etnike, luftën, identitetin kulturor dhe peisazhet e së kaluarës. Kush do të luante një lojë “fshehtas” sot? Dhe si e përse? Vizitorët në hapje do të ndeshen me Güell dhe Gërguri Stojkaj në “vizitën e tyre të pushimeve”, ndërsa vizitorët në finisazh do të shohin filmin që rezulton nga udhëtimi i tyre, i cili gjithashtu do të paraqitet online.

Núria Güell (1981) ka lindur në Vidreres dhe jeton në Barcelona.

Lumnije Gërguri Stojkaj (1976) ka lindur në Prizren dhe jeton në Gothenburg.

In 2013, Núria Güell staged a hide-and-seek game in the harbor of Gothenburg, Sweden, with an asylum seeker from Kosovo, a former policewoman named Maria. Maria was in the process of applying, for the third time, for permission to stay in Sweden. A contract was issued by the Gothenburg Biennial in Swedish and in Albanian—Maria and Edi Muka’s (the biennale’s artistic director) mother tongue. The employment contract with the art organization was made in consultation with activists and was structurally helpful in procuring Maria’s residence permit. In the hide-and-seek game, staged during the exhibition, Maria was always the one hiding, while visitors were always the ones searching. The invitation to play almost always finished with an in-depth dialogue about migration policy, political asylum, integration, and displacement, turning the game into a conversation piece. The project, organized in the frame of the seventh Gothenburg Biennial and curated by Joanna Warsza, will now be revisited on the other side of the road, in the place that Maria—whose real name is Lumnije Gërguri Stojkaj—comes from. Güell and Gërguri Stojkaj spent a short vacation in Prizren, walking, visiting, and talking. Questions arose: What is the relationship between the artist and her subject now? How to see and work with unequal relations in collaborative projects, especially around migration issues? What are the ethical ways of addressing asymmetries in art? How does Gërguri Stojkaj see art as part of her journey to Sweden, where she now works as a prison guard? On their vacation, both women talked about homeland, exile, ethnicity, war, cultural identity, and the landscapes of the past. Who would play a hide-and-seek game today? And how and why? Visitors to the opening will encounter Güell and Gërguri Stojkaj on their “vacation visit,” while the visitors to the finissage will see a film resulting from their trip, which will also be presented online.

Núria Güell (1981) was born in Vidreres and lives in Barcelona.

Lumnije Gërguri Stojkaj (1976) was born in Prizren and lives in Gothenburg.



(A B)

HAPËSIRA PËR
EDUKIM DHE PRODHIM
E AUTOSTRADA
BIENNALE/
AUTOSTRADA BIENNALE
EDUCATION AND
PRODUCTION SPACE

ISH-KAMPI USHTARAK
I KFOR-IT/ FORMER
KFOR HANGAR

RRUGA UKË BYTYÇI

BANU CENNETOĞLU

COOKING SECTIONS &
FEJSAL DEMIRAJ

FERNANDO
GARCÍA-DORY

FLAKA HALITI

IRAMAMAMA

Hapësira e Autostrada Biennale është e vendosur në ish-kampin ushtarak të KFOR-it (Forca e Kosovës), e cila tani është shndërruar në Parkun e Inovacionit dhe Trajnimit (ITP) Prizren. Lokacioni gjendet pesëmbëdhjetë minuta duke ecur nga veriu i qendrës së qytetit. Shfrytëzimi i këtij lokacioni dhe ripërdorimi me funksione të reja, është pjesë e një procesi të çmilitarizimit, ku hapësirat e mëparshme ushtarake janë shndërruar në punëtori arti e inovacioni. Forcat e armatosura Gjermane kanë filluar të përdorin kampin në vitin 1999. Lokacioni kishte një kapacitet total të akomodimit prej afërsisht 1,600 vende. Që nga viti 1999, forcat e armatosura gjermane kanë investuar në rindërtimin e kësaj zone. Përmes edukimit, trajnimit në vend dhe hapësirës së prodhimit, Autostrada Biennale synon të zhvillojë modele të reja të zhvillimit kulturor në një përpjekje për të inkurajuar brezat e rinj që të jenë pjesë e proceseve të krijimit të veprave të artit bashkëkohor dhe të angazhohen në mendimin kritik dhe praktik përmes artit. Kjo hapësirë projektuese synon të krijojë bashkjetesë ndërmjet komuniteteve duke punuar dhe prodhuar së bashku. Kjo qasje dhe metodologji bashkëkohore e krijimtarisë kulturore paraqet hapat e parë drejt krijimit të qendrës së parë të artit bashkëkohor në Prizren.

The Autostrada Biennale Education and Production Space is located in a former KFOR (Kosovo Force) military camp that was recently turned into Innovation & Training Park Prizren. It is a fifteen-minute walk north from the center of the city. Its reuse is part of a demilitarization process, with the former hangars having been turned into art workshops. The German Bundeswehr started to use the camp in 1999, and it had a total accommodation capacity of approximately 1,600. Since 1999, the Bundeswehr has invested in reconstruction of the area. Through education, onsite training, and workshops, Autostrada aims to develop new models of cultural development in an effort to encourage a young generation to participate in exhibition making and engage in critical and practical thinking through art. This project space aims to generate coexistence among communities by working and producing together. This contemporary approach and methodology of cultural production are the first steps toward the creation of the first center of contemporary art in Prizren.



BANU CENNETOĞLU

CİENNET

2019-ONGOING

Vepra e Banu Cennetoğlul është e rrënjësuar në rrëshqitje, çarje dhe disonanca, duke thyer narrativat gjithëpërfshirëse të sovranitetit. Artistja krijon sipërfaqe dhe ambiente disidente që përfshihen me tekst dhe imazh të ngarkuar me informacione. Përmes ndërhyrjeve të saj, ajo vizualizon një arkiv jo të plotë nga fragmentet e përvojës kolektive njerëzore që i reziston dhe i mbijeton logjikës nxjerrëse të kapitalizmit të përditshëm. Si një banore për një kohë të gjatë në Stamboll, Cennetoğlu është e ekspozuar ndaj proceseve të dhunshme të komodifikimit, në një qytet i cili pasqyron krizat e thella shoqërore dhe politike, të ushqyera në një kulturë post-të-vërtetës. Në 2016 u bë e qartë për Cennetoğlun, dhe për shumë qytetarë të tjerë të shqetësuar, se ndërtimi ishte jo vetëm një ushtrim i supremacisë luksoze, por edhe një metodë e rrëmbimit të tokës në emër të sovranitetit, e cila funksiononte si një model i brendshëm kolonizimi, veçanërisht në zonat e populluara dendur nga komunitetet jo-turke.

Vepra e Cennetoğlul për Autostrada Biennale është inspiruar nga betoni i gazuar—një nga materialet kryesore të ferrit të ndërtimit të Stambollit—i cili u bë një mjet i rezistencës. Shumë kompani të mëdha turke të ndërtimit kolonizojnë vendet e konsideruara si tokë e brendshme e Turqisë, prej Kosovës në Somali. Një vizion i parajsës neoliberale (*cennet*) gjeneron një ferr kolektiv të histerisë (*cinnet*). Bashkimi i këtyre dy fjalëve—*ciennet*—bëhet metafora perfekte neoliberale. Një lëshim me një shkronjë karakterizon dy horizonte të ndryshme të së ardhmes sonë, të shembura në një. E bërë me blloqe prej betoni të gazuar të lënë aty, që jeta bimore ta marrë fronin, *Ciennet* u kujton vizitorëve forma të ndryshme të fuqisë e rezistencës që kanë shënuar peisazhin e rajonit.

Banu Cennetoğlu (1970) ka lindur në Ankara dhe jeton në Stamboll.

Banu Cennetoğlu's work is rooted in slippages, ruptures, and dissonances, cracking the immersive narratives of sovereignty. She creates dissident surfaces and environments that engage with information-loaded text and image. Through her interventions, she visualizes an incomplete archive from the fragments of collective human experience that resists and survives the extractive logic of everyday capitalism. As a longtime resident of Istanbul, Cennetoğlu is exposed to the violent commodification processes in the city that reflect the deep societal and political crisis nurtured in a post-truth culture. In 2016 it became obvious to Cennetoğlu, alongside many other concerned citizens, that construction was not only an exercise of luxury supremacy but also a method of land grabbing in the name of sovereignty, which functioned as an internal colonization model, especially in areas densely populated by non-Turkish communities.

Cennetoğlu's work for Autostrada Biennale is inspired by aerated concrete—one of the primary materials of the construction hell of Istanbul—which became a tool of resistance. Many major Turkish construction companies colonize the countries considered as the hinterland of Turkey, from Kosovo to Somalia. A vision of neoliberal heaven (*cennet*) generates a collective hell of hysteria (*cinnet*). The fusing of these two words—*ciennet*—becomes the perfect neoliberal metaphor. A one letter slip characterizes two different horizons of our future, collapsed into one. Made of aerated concrete blocks left for plant life to take over, the new iteration of *Ciennet* reminds visitors of various inscriptions of power that have marked the region's landscape.

Banu Cennetoğlu (1970) was born in Ankara and lives in Istanbul.



COOKING SECTIONS &
FEJSAL DEMIRAJ

FLIA/
FLIJA

2021

Flija një gatesë e shijshme, e bërë me shtresa të miellit dhe me produkte qumështi, e gatuar ngadalë nën një kapak të nxehtë hekuri të mbuluar me qymyr druri, i njohur si *saç*, është një ushqim tradicional i përgatitur në Kosovë dhe në zonat malore përreth Shqipërisë së Veriut. Është sinonim me jetën baritore shqiptare. Flija, e rikrijuar dhe shërbyer gjatë Autostrada Biennale, bëhet një medium për të hulumtuar receta të ndryshme sipas veçantive të dheut në Kosovë, dhe për të zhvilluar teknika të reja, më të qëndrueshme për të ardhmen. Krijimi i kësaj flie trajton probleme të tilla si lodhja e tokës pas monokropimit; receta e re kërkon ta zvogëlojë sasinë e agro-kimikateve të përdorura në vjeljen e kokrrave moderne. Flija propozon një përzierje mielli (duke përdorur vetëm varietete lokale të drithërave, fasuleve apo bishtajoreve) që shton rotacionin e kulturave të llojllojshme gjatë një periudhe shumëvjeçare për të rregulluar në mënyrë të natyrshme nivelin e azotit në tokë. Receta, e gatuar dhe e shërbyer për vizitorët gjatë bienales, poashtu vlerë e shtuar në menynë e restorantit Noja, bëhet thirrje për zhvendosje kulturore dhe bujqësore në mënyrën se si njerëzit lidhen me tokën.

Cooking Sections është një kolektiv nga Londra, që eksploron se si ushqimi dhe kanalet e tij të shpërndarjes organizojnë botën. Një nga projektet e tyre afatgjata, CLIMAVORE, prezanton mënyra të reja të të ngrënit në epokën e ndryshimeve klimatike. Kur dallimet midis pranverës, verës, vjeshtës dhe dimrit janë gjithnjë më të paqarta; ndërsa oqeanet e ndotura, lodhja e tokës, rrëshqitja, pandemitë dhe thatësira janë duke u bërë më të përhapura; ne duhet t'i ndryshojmë zakonet e të ngrënit.

Receta e re e flisë është bërë në bashkëpunim me shefin e kuzhinës Fejsal Demiraj dhe projektin e tij kërkimor, Ekspedita e Gastronomisë Shqiptare.

Cooking Sections është duo që është themeluar në Londër në vitin 2013 nga Daniel Fernández Pascual dhe Alon Schwabe.

Fejsal Demiraj (1987) u lind në New York City dhe jeton në Prizren.


Flija (or *fli* or *flija*), a savory, layered flour and dairy dish cooked slowly under a hot iron lid (*saç*) covered with charcoal, is a traditional food prepared in Kosovo and the surrounding mountainous areas of northern Albania. It is synonymous with Albanian pastoral life. Flija, recreated and served during the Autostrada Biennale, becomes a medium to research different recipes according to the particularities of the soil in Kosovo, and to develop new, more sustainable techniques for the future. The creation of this flija tackles such problems as soil exhaustion after monocropping; the new recipe seeks to reduce the amount of agro-chemicals used in harvesting modern grains. It proposes a flour mix (using only local varieties of grains, beans, and pulses) that enhances polycultural crop rotation over a multiyear period to naturally fix nitrogen to the soil. The recipe, cooked for and served to visitors during the biennale, becomes a call for a cultural and agricultural shift in the way humans relate to the ground.

Cooking Sections is a collective based in London, which explores how food and its distribution channels organize the world. One of their long-term projects, CLIMAVORE, introduces new ways of eating in the era of climate change. When the lines between spring, summer, autumn, and winter are increasingly blurred; while polluted oceans, soil exhaustion, subsidence, pandemics, and droughts are becoming more prevalent; we need to change eating habits.

The new flija recipe is made in collaboration with chef Fejsal Demiraj and his research project, Albanian Gastronomy Expedition.

Cooking Sections is a London-based duo established in 2013 by Daniel Fernández Pascual and Alon Schwabe.

Fejsal Demiraj (1987) was born in New York City and lives in Prizren.



FERNANDO GARCÍA-DORY

INLAND: MOUNTAIN
TO MOUNTAIN/
INLAND: MAL NĚ MAL


2009-ONGOING

Iniciuar nga Fernando García-Dory, INLAND është një kolektiv artistik dhe një agjenci bashkëpunimesh nga Spanja, kushtuar prodhimit bujqësor, shoqëror dhe kulturor. INLAND bazohet në premisën që ruralja ofron një hapësirë fizike dhe kulturore për gjenerimin e mënyrave të ndryshme të jetës. INLAND formulon mjete kritike dhe i zbaton ato përmes praktikës eksperimentale të pastoralizmit të ri për t'u përballur me një sistem që po shembet në nivele mjedisore, kulturore dhe financiare—duke prekur edhe planetin edhe njeriun. Për bashkëpunimin me Autostrada Biennale, INLAND prezanton hulumtimin e tyre ekzistues mbi kultura të ndryshme malore dhe baritore, dhe fillon hulumtim të ri në bjeshkët e Sharrit, në kufi me Shqipërinë. INLAND ka mbledhur një ekip vendor të hulumtuesve në terren, të udhëhequr nga ekipa e Autostrada Biennale—që analizojnë hulumtimet e mëparshme dhe materialet arkivore, realizojnë intervista dhe mbledhë të dhëna. Ushtrimi hartografik kolektiv propozon mënyra të tjera për të parë territorin dhe implikimet gjeopolitike të përdorimit popullor të tokës, prodhimit të ushqimit dhe identitetit në rajon. Metodologjia sugjeron forma solidariteti midis kulturave malore nëpër të gjitha kontinentet dhe ofron lidhje mes pastoralistëve vendorë nëpërmjet Rrjetit Evropian të Barinjve, lehtësuar nga INLAND.

Fernando García-Dory (1978) ka lindur në Madrid dhe jeton në Madrid dhe Mallorca.

Initiated by Fernando García-Dory, INLAND is a Spain-based arts collective and collaborative agency dedicated to agricultural, social, and cultural production. It builds on the premise that the rural offers a physical and cultural space for the generation of diverse ways of life. INLAND formulates critical tools and applies them through experimental practice to confront various problems of a system that is collapsing at environmental, cultural, and financial levels—affecting both the planet and the individual. For its collaboration with Autostrada Biennale, INLAND presents its existing research on differing cultures around land use and begins new research on the Sharr mountains, which border Albania. INLAND has convened a local team of field researchers, lead by the Autostrada Biennale team, which is looking at previous research and archival materials, conducting interviews, and collecting data. The collective cartographical exercise proposes other ways to look at the territory, and the geopolitical implications of vernacular land use, food production, and identity in the region. The methodology suggests forms of solidarity between mountain cultures across continents and offers links between local pastoralists via the European Shepherds Network that INLAND facilitates.

Fernando García-Dory (1978) was born in Madrid and lives in Madrid and Mallorca.



FLAKA HALITI

ITS URGENCY GOT LOST
IN REVERSE (WHILE
BEING IN CONSTANT
DELAY) #4/
URGJENCA E VET
HUMBI NË KTHIM
MBRAPA (DUKE
MBETUR GJITHMONË
ME VONESË) #4

2017-21

Gë nga viti 2017, Flaka Haliti ka qenë duke ndërtuar robotë përtacë, të krijuar nga materiale të gjetura në ish-kampet paqeruajtëse të KFOR-it/NATO-s nëpër Kosovë. Robotët janë ndërtuar nga copëza dhe pjesëza të ricikluara dhe të ripërdorura prej metali, gome, sfungjeri dhe qelqi, duke përdorur kështu artin si një formë çmilitarizimi. Këta robotë ishin ndërtuar anasjelltas në kohë, si një kthim pas, me të fundit duke u konsideruar i pari në kohë. Për Autostrada Biennale, Haliti ka krijuar një robot të katërt, përfundimtar në seri, e megjithatë kronologjikisht i pari nga ato krijesa, duke e risjellur “në shtëpi”, në një ish hangar të KFOR-it gjerman, tani një park i ardhshëm i teknologjisë dhe hapësirë për ekspozita. Prapa vetes, roboti ngre në ajër krahët e tij me pamje digjitale, të përshtatur vizualisht nga pikturat e Renesancës dhe të adaptuara në një hapësirë hibride që definohet nga një rrjet gjeometrik futuristik.

Të katër robotët, duke përfshirë këtë të parin—të fundit, nuk janë çka ata supozohet të jenë—një shtesë produktive në jetën e njerëzve dhe një mobilitet mekanik i efikasitetit, apo shërbyes i ndonjë lloji. Përkundrazi, roboti shtrihet, ëndërron, pret, turbullon të kaluarën dhe të tashmen, sikur ka harruar tërë urgjencën në produktivitetin e vetë. Instalacioni i Halitit dhe një robot horizontal mund të na ndihmojnë që ta ç’identifikojmë dhe ta përçajmë sferën publike, ta hapim atë për më shumë mënyra minoritare, ‘queer’ si ndërpavaresi, të të qenurit dhe të bërit. Frymëzuar nga shkrimet e José Esteban Muñoz, artistja pyet se si do të mund të dukej një e ardhme tjetër, e dekolonizuar dhe më pak e dhunshme, për Kosovën dhe botën në përgjithësi. Ç’ndjesi do të ishte, ç’aromë do të mbante e ç’pamje do të kishte, me robotë të tillë bizarre të çuditshëm duke hapur rrugën?

Flaka Haliti (1982) ka lindur në Prishtinë dhe jeton në Prishtinë dhe Mynih.

Since 2017, Flaka Haliti has been constructing lazy robots, composed from material found in the former KFOR/NATO peacekeeping camps across Kosovo. The robots have been made from recycled and repurposed bits and pieces of metal, rubber, sponge, and glass, using art as a form of demilitarization. They were constructed in reverse, as if turning time, with the last being the first. For Autostrada Biennale, Haliti has created a fourth, final, and yet chronologically the very first of those creatures, bringing it “home,” into a former German KFOR hangar, now a future technology park and exhibition venue. Behind the robot levitates its digital-looking wings, visually appropriated from Renaissance paintings and inscribed into a hybrid space that is defined by a geometric futuristic grid.

All four robots, including this first-last one, are not what they are supposed to be—a productive addition to the life of humans, a machinic extension of efficiency, a servant of sorts. Quite the contrary, it lays flat, dreams, waits, blurs the past and the present, as if it forgot all of its urgency and efficiency. Haliti’s installation and a horizontal robot can help us to disidentify and disrupt the public sphere and open it for more queer, minoritarian, interdependent ways of being and doing. Inspired by the writings of José Esteban Muñoz, the artist asks what another, decolonized, and less violent future for Kosovo and the world at large could look like. How would it feel, smell, and look with such uncanny robots paving the way?

Flaka Haliti (1982) was born in Prishtina and lives in Prishtina and Munich.



IRAMAMAMA

BANDUNG CONFERENCE
1955: A SOUNDTRACK
FOR THE OTHER
END OF THE ROAD/
KONFERENCA E BANDUNG
1955: NJË KOLONË
ZANORE PËR SKAJIN
TJETËR TË RRUGËS

2019 & 2021

Iramama është një duo kushërinjsh nga Xhakarta, të bashkuar nga i njëjti pasion për muzikën dhe dëshira për të mbledhur pllaka të vjetra vinili (vinyl records). Kolona zanore e tyre për Autostrada Biennale luan muzikë të bërë në Azinë Juglindore rreth kohës së Konferencës së Bandungut, në vitin 1955. Ky ishte takimi i parë i gjerë i shteteve aziatike dhe afrikane të sapo pavarësuar, dhe u zhvillua në Java Perëndimore (West Java). Një nga qëllimet e takimit ishte kundërshtimi i kolonializmit dhe neokolonializmit, dhe hodhi bazat për krijimin e Lëvizjes së të parreshtuarve (NAM), e cila u themelua në vitin 1961 në Beograd. Qëllimi kryesor i lëvizjes ishte të shmangte botën e polarizuar të Luftës së Ftohtë dhe të refuzonte çdo bllok të madh të fuqive.

Anëtarët e Iramamama u takuan me arkivistët dhe historianët e muzikës për të studiuar rëndësinë e muzikës si kulturë dhe shprehje sociopolitike. Ky mixtape muzikor është bërë në bashkëpunim me Irama Nusantara, një iniciativë arkivore e muzikës popullore indoneziane nga vitet e 1910-ta deri në vitet 1980-ta. Formon një arkiv të gjallë të shoqërisë së Azisë Jugore. Fillimisht u krijua si një mixtape me dy anë: A dhe B. Është një kolonë zanore që tregon se si muzika u përdor në përpjekjet anti-koloniale në kërkim të një shoqërie më të barabartë. Mixtape-i u lajt si pjesë e ekspozitës “Konstelacionet e Jugut: Poetika e të parreshtuarve” në Muzeun e Artit Bashkëkohor Metelkova, Lubjanë, në 2019; në Autostrada Biennale, na rikujton rolin e mundshëm emancipues të kulturës në një rrugëtim të gjatë drejt një shoqërie më të mirë dhe më të drejtë.

Iramamama, Marishka Soekarna (ka lindur në Bandung, 1983) dhe Ken Zefanya (ka lindur në Xhakarta, 1983), jetojnë në Xhakarta dhe Kassel.

Iramamama is a cousin duo from Jakarta, allied by the interest in music and collecting old vinyl records. Their soundtrack for Autostrada Biennale plays music made in Southeast Asia around the time of the Bandung Conference in 1955, the first large-scale meeting of newly independent Asian and African states that took place in West Java. One of its goals was to oppose colonialism and neocolonialism, and it laid the grounds for the creation of the Non-Aligned Movement, which was founded in 1961 in Belgrade. Its major aim was to avoid the polarized world of the Cold War and to refuse any major power bloc.

Iramamama met with music archivists and historians to study the significance of music as cultural and sociopolitical expression. This mixtape is made in collaboration with Irama Nusantara, an archival initiative of Indonesian popular music from the 1910s to the 1980s. It forms a living archive of South Asian society—a soundtrack of how music was employed in the anticolonial struggle in search of a more equal society. The mixtape was played as part of the exhibition “Southern Constellations: The Poetics of the Non-Aligned” at the Museum of Contemporary Art Metelkova, Ljubljana, in 2019; at Autostrada Biennale it reminds us of a possible emancipatory role of culture in a long journey to a better and fairer society.

Iramamama, Marishka Soekarna (born in Bandung, 1983) and Ken Zefanya (born in Jakarta, 1983), live in Jakarta and Kassel.

SIDE A

- | | | |
|-----------------------------|-----------------------|----------------------|
| 1. | 5. | 9. |
| - "Djakarta Sepintas Lalu" | - "Awaz Bing Awaz" | - "Kudaku Lari" |
| - (Utjin Nurhasjim) | - (A. Dei) | - (A. Harris) |
| - Soebardini | - Kartini | - Hasnah Tahar |
| - Orkes Kerontjong | - Orkes Kerontjong | - Orkes Melaju Bukit |
| M. Sagi dbp. | M. Sagi dbp. | Siguntang dbp. |
| Isbandi | M. Sagi | A. Chalik |
| 2. | 6. | 10. |
| - "Tjelana Yankee" | - "Krisis" | - "Ardjuna Djakarta" |
| - (Henny Gatot) | - (G. R. W. Sinsu) | - (A. Usman) |
| - Ati | - Boetje Pesulima | - Noeri Satryo |
| - Orkes dbp. | - Orkes dbp. | - Orkes Lima Serama |
| Henny Gatot | Henny Gatot | dbp. A. Usman |
| 3. | 7. | 11. |
| - "Kong Kalikong" | - "Hari Lebaran" | - "Tiga Dara" |
| - (Isbandi/Utjin Nurhasjim) | - (Ismail Marzuki) | - (Saiful Bahri) |
| - Kartini | - Didi | - Tiga Dara |
| - Orkes Kerontjong | - Kwartet dbp. | - Orkes Saiful Bahri |
| M. Sagi dbp. | Mascan | |
| Isbandi | 8. | |
| 4. | - "Serba-Serbi Batik" | |
| - "Aku Djadi Kepala" | - (Ismail Marzuki) | |
| - (R. Soetedjo) | - Didi | |
| - Didi | - Orkes Kerontjong | |
| - Orkes Hawaiian | - Mustika dbp. | |
| Taruna dbp. | Adikarso | |
| Max van Dalm | | |

SIDE B


- | | | |
|--------------------------------------|---------------------------------------|-----------------------------------|
| 1. | 5. | 9. |
| - "Untuk PJM Presiden Sukarno" | - "I-Jo-I-Jo" | - "Kaden Sadje" |
| - (Sutedjo) | - (Januar Arifin) | - (Wedhasmara) |
| - Lilis Surjani | - Sjaiful Nawas | - Wedhasmara |
| - Orkes Bayu dbp. | - Orkes Gumarang dbp. Asbon | - Zaenal Combo dbp. Zaenal Arifin |
| F. Parera | | |
| 2. | 6. | 10. |
| - "Bersuka Ria" | - "Angkat Sampeong" | - "Te 0 Rendang 0" |
| - (Bung Karno) | - (Trad.) | - (Trad.) |
| - Rita Zaharah, | - Rudy Rusadi | - Max Lesiangi |
| Bing Slamet, | - Eka Djaja Combo | - Zaenal Combo dbp. Zaenal Arifin |
| Titiek Puspa, | dbp. Rudy Rusadi | |
| Nien | 7. | 11. |
| - Orkes Irama dbp. Jack Lesmana | - "Tandjung Tjina" | - "Bengawan Solo" |
| 3. | - (Auladi) | - (Gesang) |
| - "Tam Tam Buku" | - Bing Slamet | - Oslan Husein |
| - (Trad.) | - Orkes | - Orkes Irama Cubana |
| - Mus D. S. | Mambetarumpadjo | Teruna Ria dbp. Zaenal Arifin |
| - Orkes Reka Musika dbp. Mus D. S. | dbp, Bing Slamet | |
| 4. | 8. | |
| - "Tak Ton Tong" | - "Pantjaran Kasih" | |
| - (Trad.) | - (A. Muis Radjab) | |
| - Oslan Husein | - T. Kamarul Zaman | |
| - Orkes Teruna Ria dbp. Oslan Husein | - Orkes Tropicana dbp. A. Muis Radjab | |

- Titulli/ Title
 - Këngëtar/ Singer
 - Grupi/ Group
 - Udhëheqës i grupit/ Group leader



PEJA

19.07–
11.09.2021





(E E)

EX-EXIT

RRUGA GENERAL
WESLEY CLARK

AGUSH BEQIRI
REMADE BY
VJOLLCA HAXHIU

HÜSEYİN BAHRİ
ALPTEKİN

EXIT ishte një hapësirë e pavarur arti që u hap në Pejë në verën e vitit 1999, pas hyrjes së NATO-s në Kosovë. U themelua nga Sokol Beqiri dhe Erzen Shkololli, dy artistë që po i përgjigjeshin mungesës së platformave infrastrukturore për artistë, kuratorë dhe menaxherë kulturorë në Kosovë. EXIT ofroi një model artistik alternativ në një situatë pas konflikti, me ekspozita inovative, bashkëpunime ndërkombëtare, programe publike dhe punëtori me komunitete të ndryshme rreth çështjeve të tilla si identiteti post-konfliktual, lokal dhe evropian.

Galeria EXIT ishte një hapësirë shumë e rëndësishme për skenën e artit kosovar dhe një platformë për shumë bashkëpunime ndërkombëtare dhe lokale, duke mirëpritur artistë dhe kuratorë të tillë si Edi Muka; Edi Hila; Danica Dakić; Kurt & Plasto; Grupi Blue Noses; Margarethe Makovec dhe Anton Lederer; Dan Perjovschi; Sanja Iveković; Ayşe Erkmen; Róza El-Hassan; Christoph Keller; Vlatka Horvat; David Maljkovic; What, How & for Whom (WHW); Anri Sala; Zdena Kolečková; Michaela Thelenová; dhe shumë të tjerë.

EXIT was an independent art space that opened in Peja in the summer of 1999 after NATO's arrival in Kosovo. It was founded by Sokol Beqiri and Erzen Shkololli, two artists who were responding to a lack of infrastructural platforms for artists, curators, and cultural managers in Kosovo. EXIT offered an alternative artistic model in a post-conflict situation with groundbreaking exhibitions, international collaborations, public programs, and workshops with various communities around ideas such as post-conflict, local, and European identity.

EXIT Gallery was a very important space for the Kosovar art scene, and a platform for many international and local collaborations, hosting such artists and curators as Edi Muka; Edi Hila; Danica Dakić; Kurt & Plasto; the Blue Noses Group; Margarethe Makovec and Anton Lederer; Dan Perjovschi; Sanja Iveković; Ayşe Erkmen; Róza El-Hassan; Christoph Keller; Vlatka Horvat; David Maljkovic; What, How & for Whom (WHW); Anri Sala; Zdena Kolečková; Michaela Thelenová; and many others.



AGUSH BEQIRI
REMADE BY
VJOLLCA HAXHIU

Agush Beqiri (1932–2006)
ka lindur në Pejë dhe ka jetuar
në Pejë dhe Prishtinë/ was born
in Peja and lived in Peja and
Prishtina.


Vjollca Haxhiu (1966)
ka lindur në Krujë dhe jeton
në Krujë/ was born in Kruja
and lives in Kruja.

Sot Sokol Beqiri thotë se ai është më i interesuar për jetën sesa artin. EXIT vazhdon të punojë si lokal dhe është një pikëtakim i famshëm në Pejë për komunitete të ndryshme. Gjatë kohëzgjatjes së Autostrada Biennale, ky vend rilidhet me ditët institucionale të artit. Hapësira sërish mirëpret një ekspozitë që thekson narrativat e farefisnisë dhe miqësisë, dhe paraqet një takim imagjinar të dy miqve të ndjerë: babait të Sokol Beqirit, Agush Beqiri, i cili ishte arkitekt, artist dhe dizajner; dhe shokut të tij të ngushtë nga Stambolli, artistit Hüseyin Bahri Alpteki. Një nga skicat e përealizuara të qilimave të Beqirit, që përmban një interpretim modernist të traditës dhe folklorit, do të sjellet në jetë nga artizanja shqiptare Vjollca Haxhiu, krahas një përzgjedhjeje të skicave të veprës së Alptekin titulluar *ELITE*, frymëzuar nga lokali i Aki Kaurismakit në Helsinki.

Alptekin ishte një figurë qendrore në skenën e artit bashkëkohor në Turqi dhe në jetën e tij nomade udhëtoi nëpër botë, duke kaluar një kohë të madhe në Kosovë. Puna e tij e ekspozuar u përzgjodh nga partnerja jetësore dhe artistike e Alptekin, Camila Rocha, për këtë rast. (Rocha vetë ka punuar një vepër për Autostrada Biennale në Prizren.)

Today Sokol Beqiri claims he is more interested in life than art. EXIT continues as a bar, and remains a hotspot in Peja for various communities. For the duration of the Autostrada Biennale, the place reconnects with its art-institutional days. It again hosts an exhibition highlighting narratives of kinship and friendship, and it presents an imaginary meeting of two late friends: Sokol Beqiri's father, Agush Beqiri, who was an architect, artist, and designer; and his close friend from Istanbul, the artist Hüseyin Bahri Alpteki. One of Beqiri's unrealized carpet sketches, which features a modernist interpretation of tradition and folklore, will be brought to life by Albanian craftswoman Vjollca Haxhiu, alongside a selection of sketches Alptekin's work *ELITE*, which is inspired by Aki Kaurismaki's bar in Helsinki.

Alptekin was a crucial figure in the contemporary art scene in Turkey and in his nomadic life traveled the world, spending a significant amount of time in Kosovo. His work on view was selected by Alptekin's life and artistic partner Camila Rocha for the occasion. (Rocha herself realized a commission for the Autostrada Biennale in Prizren.)



HÜSEYİN BAHRİ
ALPTEKİN

ELITE

1999

Hüseyin Bahri Alptekin (1957–2007)
ka lindur në Izmir dhe ka jetuar
në Istanbul/ was born in Izmir
and lived in Istanbul.

Për kuratorët, këto marrëdhënie farefisnore janë nderim për veprimet e së kaluarës në ndërtim të infrastrukturave për Kosovën, dhe komunitetet e ndryshme artistike që sollën së bashku—sepse në një periudhë të distancave dhe izolimit pandemik, marrëdhëniet tona kërkojnë ribërje dhe ritregim.

For the curators, these kinship relations are a salute to the past actions of building artistic infrastructures for Kosovo and the different artistic communities they brought together—because in a period of pandemic distances and isolation, our relations require a remapping and retelling.

WHAT IF A JOURNEY...

This book is published by Autostrada Biennale within the scope of its third edition curated by Övül Ö. Durmuşoğlu and Joanna Warsza.

ÇKA NËSE NJË RRUGËTIM...

Ky libër është botuar nga Autostrada Biennale në kuadër të edicionit të tretë, kuruar nga Övül Ö. Durmuşoğlu dhe Joanna Warsza.

© 2021

All rights reserved. No part of this publication may be reproduced in any form or by any means, without the written consent of the Autostrada Biennale.

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet në asnjë formë ose në asnjë mënyrë, pa miratimin me shkrim të Autostrada Biennale.

Bashkëthemelues të Autostrada Biennale/
Autostrada Biennale Cofounders
Leutrim Fishekqiu
Vatra Abrashi
Bariş Karamuço

Kuratore e Edicionit të Tretë/ Curators of the Third Edition
Tekstet/ Texts
Övül Ö. Durmuşoğlu & Joanna Warsza

Kryeredaktore/ Managing Editor
Leah Whitman-Salkin

Përkthyes/ Translator EN-AL
Rita Bekqeli

Lektor/ Proofreader AL
Arbër Selmani

Lektor/ Proofreader EN
Raphael Wolf

Fotografitë e Hapësirave/ Venue Photos
Bariş Karamuço
Dren Maliqi (faqe/ page 272)

Dizajni/ Design
Studio Permanent:
Nita Salihu Hoxha
Urtina Hoxha (Hartat/ Maps)

Shtypi/ Print
Vi-Print

Dizajni i këtij libri u frymëzua nga vepra e Valbona Zherkës me titullin *Shtegtimi*/ The design of this book was inspired by Valbona Zherka's artwork *Migration*.

Drejtues i Produksionit/ Head of Production
Patrick Burke

Koordinatorët e Produksionit/ Production Coordinators
Engjell Berisha
Hamdi Bajraktari

Koordinatori i Logjistikës/ Logistics Coordinator
Admir Abrashi

Administratë & Financa/ Administration & Finance
Dren Dorambari
Driton Randobrava

Asistente e Projektit/ Project Assistant
Vlora Hajrullahu

Fotograf/ Photographer
Tuğhan Anıt

Editor i Videove/ Video Editor
Gencer Tatar

Arkitekt/ Architect
Gençer Tatar

Arkitekt/ Architect
Rron Beqiri

Agronom/ Agronomist
Alkend Tahirsyla

Instalues/ Installer
Skender Xhukolli

Zdrukthtar/ Carpenter
Besnik Fetahu


autostradabiennale.org

3. AUTOSTRADA BIENNALE

U MUNDËSUA PËRMES MBËSHTETJES DHE
PARTNERITETIT TË/ IS MADE POSSIBLE
WITH THE GENEROUS SUPPORT AND
PARTNERSHIPS OF

3. AUTOSTRADA BIENNALE

Mbështetur nga/ Supported by



Swiss Cooperation Office Kosovo



PRISHTINA



UNITED NATIONS KOSOVO TEAM



WHAT IF A JOURNEY...

European Cultural Foundation



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT
MINISTRATVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORT

SUSTAINABLE DEVELOPMENT GOALS



GOETHE-ZENTRUM KOOPERATIONSPARTNER



SUPPORTING CONTEMPORARY ART FROM TURKEY

SHE

Partnerët/ Partners

Manifesta 14
Prishtina 2022



STACIONI I AUTOBUSAVE PRIZREN



THE 5TH ANNUAL KOSOVO PRIDE WEEK



BIBLIOTHEKA KOMBETARE E KOSOVËS
"FJETER BODGANI" "FJETER BODGANI"



eva INTERNATIONAL IRELAND'S BIENNIAL

ERAC EUROPEAN ROMA INSTITUTE FOR ARTS AND CULTURE

Hapësira për Edukim dhe Prodhim e Autostrada Biennale është mbështetur nga/ Autostrada Biennale Education and Production Space is supported by



gjirafa50.com







WHAT

KURUAR NGA/ CURATED BY
ÖVÜL Ö. DURMUŞOĞLU &
JOANNA WARSZA

JOURN